


Përmbledhje e Problematikave Kryesore të Menaxhimit të Ujërave në Basenin Ujor të Matit



Dokument për Këshillim Paraprak me Palët e Interesit dhe Publikun e Gjerë Korrik 2020



Pjesë e dokumentacionit përbërës të **Planit Menaxhimit të Basenit Ujor për Basenin Ujor të Matit**

Përgatitur nga: Erjola KECI
Eksperte teknike për Menaxhimin e Cilësisë së Ujit,
Projekti EUSWIM, Agjencia Austriake për Zhvillim

Ky Projekt bashkëfinançohet nga BE-ja dhe Agjencia Austriake për Zhvillim

Faqe | ii



 Austrian
Development
Agency

Tabela e përmbajtjes

1. PËRMBLEDHJE E PLANIFIKIMIT PËR BASENET UJORE	1-1
1.1 KONTEKSTI LIGJOR.....	1-1
1.2 HAPAT KYÇË	1-1
1.3 KOHËZGJATJA E PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	1-2
1.4 PROBLEMATIKAT KRYESORE TË MENAXHIMIT TË UJËRAVE NË BASENIN UJOR TË MATIT.....	1-2
2. MËNYRA E PROJEKTIMIT TË KËTIJ KONSULTIMI.....	2-1
2.1 TEMAT THEMELORE.....	2-1
2.2 PËRMBAJTJA E TEMAVE DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	2-1
2.3 SI MUND T’I PËRGJIGJEM KËTIJ KONSULTIMI?	2-3
2.4 PËRMBLEDHJE.....	2-4
3. BASENI UJOR I MATIT.....	3-1
4. NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE BURIMET UJORE	4-2
4.1 PËRSE KA RËNDËSI KJO?	4-2
4.2 PROBLEMATIKAT AKTUALE	4-3
4.3 PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN	4-5
4.4 MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	4-5
5. TË DHËNAT HIDROMETEOROLOGJIKE DHE RRJETET E MONITORIMIT.....	5-1
5.1 PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME?.....	5-1
5.2 PROBLEMATIKAT AKTUALE	5-1
5.3 PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN	5-2
5.4 MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	5-3
6. ZONAT E MBROJTURA DHE EKOSISTEMET UJORE.....	6-1
6.1 PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME?.....	6-1
6.2 PROBLEMATIKAT AKTUALE	6-1
6.3 PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN	6-2
6.4 MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	6-3
7. PËRMBYJTJET DHE THATËSIRAT	7-1
7.1 PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME?.....	7-1
7.2 PROBLEMATIKAT AKTUALE	7-1
7.3 PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN	7-2

7.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	7-3
8.	<u>MORFOLOGJIA E VIJIMËSISË SË KANALEVE DHE FUSHAVE LYMORE</u>	8-1
8.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME?.....	8-1
8.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE	8-1
8.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN	8-2
8.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	8-3
9.	<u>PRURJET MJEDISORE.....</u>	9-1
9.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME?.....	9-1
9.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE	9-1
9.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN	9-2
9.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	9-4
10.	<u>PËRDORIMI I UJIT, MARRJA E UJIT DHE LEJA PËR MARRJE</u>	10-1
10.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME?.....	10-1
10.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE	10-1
10.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN.....	10-2
10.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	10-3
11.	<u>SHKARKIMET E UJËRAVE TË NDOTURA, NDOTJA E UJËRAVE DHE LEJA PËR SHKARKIM</u>	11-5
11.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME.....	11-5
11.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE.....	11-6
11.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN.....	11-7
11.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR.....	11-7
12.	<u>DIGAT DHE HIDROCENTRALET</u>	12-1
12.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME.....	12-1
12.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE.....	12-1
12.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN.....	12-1
12.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	12-1
13.	<u>SHFRYTËZIMI, MBROJTJA DHE MONITORIMI I UJËRAVE NËNTOKËSORE.....</u>	13-2
13.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME.....	13-2
13.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE	13-2
13.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN.....	13-7
13.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	13-8
14.	<u>CILËSIA E UJËRAVE BREGDETARE, UJËRAT PËR LARJE, HABITATET</u>	14-1

14.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME.....	14-1
14.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE	14-1
14.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN.....	14-2
14.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	14-2
15.	<u>MENAXHIMI I BREGDETIT, RISKU I PËRMBYTJEVE DHE EROZIONI</u>	15-1
15.1	PËRSE KJO PROBLEMATIKË ËSHTË E RËNDËSISHME.....	15-1
15.2	PROBLEMATIKAT AKTUALE	15-1
15.3	PASOJAT DHE NEVOJAT NË TË ARDHMEN.....	15-2
15.4	MASAT QË MUND TË ZBATOHEN NË KUADËR TË PLANIT TË MENAXHIMIT TË BASENIT UJOR	15-2
16.	<u>PROGRAMI I ZBATIMIT.....</u>	16-3

Deklarata e pajtueshmërisë

Ky dokument iu përmbahet të gjitha kërkesave të Nenit 15 dhe Nenit 17 të Ligjit “Për Konsultimin Publik”.

Ky dokument ka për qëllim t'i përmbahet Nenit 14 të Direktivës 2006/60/KE së BE-së, Konsultimi publik për zhvillimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore.

Parathënie

Të nderuar kolegë, pjesëtarë të publikut, profesionistë të ujit dhe mjedisit, dhe palë interesi në përgjithësi. Dëshirojmë t'ju urojmë mirëseardhjen në hapin madhor të radhës së përgatitjes së **Planit** zyrtar të **Menaxhimit të Basenit Ujor (PMBU)** për Basenin Ujor të **Matit**.

Ky Plan po përgatitet nga **Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore (AMBU)** nën drejtimin e Këshillit të Basenit Ujor Mat, dhe Këshillit Kombëtar për Ujin, që i raporton Kryeministrit. Kjo Përmbledhje është në përputhje me kërkesat e Nenit 14.1 (b) të Direktivës Kuadër të Ujit (DKU) të Bashkimit Evropian (BE) për t'iu mundësuar palëve të interesit një "përmbledhje të ndërmjetme të problematikave kryesore të menaxhimit të Ujërave" dy vite përpara nisjes së periudhës së referuar në plan (në rastin konkret, në muajin janar 2022).

Objekivi kryesor i kësaj **Përmbledhje të Problematikave Kryesore të Menaxhimit të Ujërave** është të sigurojë një panoramë të përgjithshme jo teknike të atyre që ne i konsiderojmë si sfidat aktuale kryesore të menaxhimit të ujërave në basenin ujor të Matit. Së dyti, me qëllim nxitjen e përgjigjeve dhe diskutimit nga ana e palëve të interesit (përkufizuar si publiku i përgjithshëm dhe furnizuesit e tjerë, konsumatori ose përdoruesit e shërbimeve ujore që përfitojnë nga burimet ujore dhe shërbimet e ekosistemit në basenet ujore), AMBU propozon një sërë përgjigjesh apo masash të mundshme menaxhimi, për menaxhimin apo mbrojtjen, dhe përmirësimin më të mirë të lumenjve, liqeneve dhe brigjeve tona detare, që nevojiten në kuadrin e standardeve evropiane.

Për shkak të përdorimit të mundshëm të paqëndrueshëm dhe cilësisë mesatare të ujërave natyrore në disa nga basenet tona ujore, duhet të përmirësojmë menaxhimin dhe të zbatojmë përdorimin e duhur të burimit tonë më të vyer, ujit. Deklaratat e përfshira në këtë dokument, janë pikëpamjet fillestare të AMBU, në cilësinë e autoritetit ligjor kompetent të autorizuar për hartimin dhe zbatimin e PMBU-ve, sipas procedurave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 1, datë 17.2.2015, **Këshilli i Basenit Ujor (KBU)** në çdo basen ujor duhet të garantojë që çdo palë interesi, përfshirë publikun e gjerë, ka mundësinë të shprehë pikëpamjet dhe opinionin e vet profesional për Planet e propozuara. PMBU-ja përfundimtare e miratuar dhe publikuar duhet të marrë në konsideratë komentet gjatë konsultimeve në ato raste kur ato janë me rëndësi shoqërore, ekonomike apo teknike.

Në kuadrin e një sërë temash kryesore, pjesët në vijim përcaktojnë ato çka AMBU i konsideron përparësi, shoqëruar me zgjidhje të mundshme. Në disa raste, propozimet tona mund të kërkojnë ndryshime të konsiderueshme në politika, procedura veprimi nga ana e furnizuesve madhorë të ujit, si furnizuesit e ujit të pijshëm në bashki, hidrocentralet dhe ujitja, ose përmirësim i mbledhjes së të dhënave dhe zbatimit të legjislacionit nga ana e Agjencive kombëtare. Veçanërisht në këtë kuadër, ftojme palët e interesit të komentojnë propozimet tona fillestare.

Nënshkroi

Drejtori i Përgjithshëm - AMBU

1. Përmbledhje e Planifikimit për Basenet Ujore

1.1 Konteksti Ligjor

Përafrimi me acquis-të mjedisore të BE-së është një faktor i rëndësishëm shtysë për Shqipërinë. Që prej vitit 2011, vendi ka përparuar me përmirësimin e legjislacionit të vet për të përmbushur kërkesat e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, duke përafuar në të njëjtën kohë politikat mjedisore të BE-së. Në kuadrin e anëtarësimit në BE, Shqipëria duhet të përmbushë plotësisht kushtet dhe detyrimet e “Kapitullit 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike” të acquis-ve të BE-së (kushtet për anëtarësimin). Planet e Menaxhimit të Baseneve Ujore (PMBU-të) të konsultuara dhe të hartuara ligjërisht përbëjnë pjesë thelbësore të këtyre detyrimeve.

Ligji Nr. 111/2012 për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore që ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2013 dhe është ndryshuar në vitin 2018, mundëson menaxhimin e integruar të burimeve ujore (MIBU) si dhe përafrimin e Direktivës Kuadër të Ujit (DKU), që në Vendet Anëtare konsiderohet si një nga dokumentet legjislative mjedisore më të rëndësishme për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe bregdetare. Të gjitha Vendet Anëtare kanë detyrime ligjore lidhur me hartimin dhe publikimin e PMBU-ve për basenet ujore përkatëse. Shqipëria ka shtatë basene ujore me ‘Autoritetet Rajonale të Baseneve Ujore’ të ngritura përkatësisht dhe të identifikuara në VKM Nr. 696, datë 30.10.2019 “Për përcaktimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën dhe përbërjen e çdo këshilli të basenit ujqor”.

Uji është burimi ynë natyror më jetik dhe më i rëndësishëm. Ai është në sasi të kufizuar, prandaj, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018, burimet ujore duhet të rregullohen me qëllim përdorimin e tij në përputhje me nevojat, në mënyrë të qëndrueshme mjedisore dhe ekonomikisht produktive.

Megjithëse mund të ekzistojnë strategji sektoriale specifike, për shembull, për nxjerrjen e ujit nga bashkia, trajtimin e ujërave të ndotura, përdorimin e ujit për vaditje, përdorimin e ujit për zhvillim industrial dhe ekonomik, zhvillimin energjetik në formën e hidrocentraleve ose strategjinë kombëtare për mbrojtjen mjedisore, të gjitha këto strategji sektoriale duhet të jenë të balancuara dhe të koordinuara në kuadrin e objektivave të PMBU-së së botuar. Në veçanti, duhet të identifikohet plotësisht kostoja e lartë mjedisore e nxjerrjes së ujit nga mjedisi dhe përdorimi i tij në ekonomi, si dhe duhet të rikuperohet kjo kosto në përputhje me masat e përcaktuara në PMBU.

1.2 Hapat Kyçë

Ligji për Ujin në Shqipëri (Nr. 111/2012, i ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2018), duke siguruar një kuadër për krijimin e menaxhimit të integruar të basenit ujqor, në përputhje me DKU-në, përcakton se çfarë duhet të përfshijnë nga pikëpamja e përmbajtjes PMBU-të, në përputhje me Shtojcën VII të DKU-së.

Hapat kyçë për hartimin e secilit plan për menaxhimin e basenit ujqor, procesi i konsultimit me palët e interesit dhe pjesëmarrja e publikut janë të përcaktuara me Vendimin Nr. 1 të Këshillit Kombëtar të Ujit, datë 17.02.2015.

Së pari, baseni ujqor duhet të klasifikohet në terma të llojit të trupave ujqorë të pranishëm (lumenj, liqene, ujëra nëntokësore dhe zona bregdetare) dhe sa i përket kushteve të veçanta të llojit, në mënyrë që të përcaktojmë objektivist nëse këta trupa ujqorë përmbushin standardin e BE-së të **'Statusit të Mirë'**, që përfshin si standardet për sasinë, ashtu edhe për cilësinë e ujit.

Me qëllim që të kuptojmë përse mund të kemi trupa ujqorë që nuk janë në statusin e duhur, duhet të kryejmë një vlerësim të trysnive mbi ujërat sipërfaqësore dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe burime natyrore.

Zyra e Administrimit të Basenit Ujqor (ZABU), sipas përcaktimit të Ligjit Nr. 111/2012, i ndryshuar, duhet të hartojë një analizë ekonomike të përdorimit të ujit dhe produktivitetit në basen, veçanërisht për të përcaktuar nëse uji po përdoret në mënyrë të efektshme dhe nëse kosto e vet e vërtetë mjedisore po rikuperohet nga përdoruesit e ujit.

Në fund, hartohet një plan për menaxhimin e ujit dhe lehtësimin e ndikimeve negative në mjedis.

1.3 Kohëzgjatja e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujqor

PMBU-ja është një variant i përditësuar i planit ekzistues, që është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit me vendimin Nr. 3, datë 12.10.2012. Duke qenë se planet e menaxhimit të baseneve ujqore kanë vlefshmëri gjashtë vjeçare, dhe duke qenë se Vendet Anëtare të BE-së po zbatojnë aktualisht ciklin e tyre të dytë të PMBU-ve (2016-2021) dhe janë tashmë duke përgatitur ciklin e tretë (2022-2027), Këshilli Kombëtar i Ujit beson se Shqipëria duhet të tregojë angazhimin e saj për procesin e anëtarësimit duke zbatuar ciklin e vetë të parë të planeve të menaxhimit të baseneve ujqore në përputhje me ciklin e tretë të PMBU-ve në BE, përkatësisht në periudhën 2022-2027, kështu që pritshmëritë janë që ky Plan i Menaxhimit të Basenit Ujqor të Matit të zbatohet në periudhën 2022-2027.

1.4 Problematikat Kryesore të Menaxhimit të Ujërave në Basenin Ujqor të Matit

Monitorimi dhe vlerësimi i statusit të trupave ujqorë në Basenin Ujqor të Matit, në përputhje të plotë me DKU-në, konsiderohen të mos jenë aktualisht të mundshëm, sepse përbërjet me përparësi dhe elementët e cilësisë biologjike të DKU-së së BE-së (fauna bentike jovertebrore, fitoplanktoni, fitobentosi, makrofitët dhe peshqit) nuk monitorohen ende në mënyrë rutinë, dhe skema e klasifikimit për vlerësimin e statusit të ujit në lumenj aktualisht në përdorim në Shqipëri nuk është e hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e DKU-së, megjithëse dallon pesë klasa të etiketuara nga "i lartë" në "keq".

Megjithatë, justifikohet hartimi i një brezi të parë të planeve të menaxhimit të baseneve ujqore duke u përqendruar paraprakisht në elementet e cilësisë fiziko-kimike dhe kërkesat e përgjithshme për sasinë e ujit, jo vetëm për shkak të ndërlikimeve të paraprirura me monitorimin dhe vlerësimin e statusit kimik dhe ekologjik, POR për shkak të interesit kyç në

procesin e formulimit, arritjes së konsensusit dhe zbatimin faktik të programeve të masave.

Kërcënimet kryesore për zonën ujëmbledhëse të Matit përfshijnë ekuilibrin e paqëndrueshëm midis kërkesës dhe përdorimit të ujit, erozionin, shfrytëzimin e tepërt të shtresës ujëmbajtëse (për shembull nxjerrjet e shumta individuale dhe të palicencuara të ujërave nëntokësore që vërehen në të gjitha rajonet tona bujqësore, çka mund të jetë duke dëmtuar qëndrueshmërinë afatgjatë të rezervave të pazëvendësueshme të ujërave nëntokësore), ndotjen nga shkarkimet e ujërave të ndotura të patrajuara dhe ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike.

Megjithëse nuk mund të trajtojmë dhe zgjidhim çdo problematikë në PMBU-në e parë, duhet të përpiqemi të identifikojmë problematikat më të rëndësishme dhe serioze që aktualisht ndikojnë trupat ujorë, dhe të ofrojmë një ide për mënyrën se si planifikojmë t'i menaxhojmë ato përmes një plani sistematik dhe të strukturuar veprimtarish, i ashtuquajtur **Programi i Masave**, në mënyrë që të sigurojmë se kemi sasinë dhe cilësinë e mjaftueshme të ujit për përdorim afatgjatë. Në veçanti, këtu përfshihen nevojat e ekosistemeve të vyera ujore.

Programi i masave do të përgatitet bazuar në informacionin e disponueshëm që supozohet të ndryshojë vazhdimisht si pasojë e monitorimit të vazhdueshëm dhe të planifikuar dhe përforsimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të autoriteteve të përfshira. Në këtë kontekst, programi i masave do të shihet vetëm si një program kuadër, që duhet të detajohet më tej në të ardhmen.

Disa nga veprimet urgjente bazë që do të merren në kuadër të planit të menaxhimit kërkojnë:

- shtimin e veprimtarive për monitorimin e përgjithshëm të ujit dhe shpërndarjen e burimeve për të përmirësuar kapacitetin analizues dhe akreditimin e laboratorëve
- krijimin e monitorimit ekologjik sipas nevojës për përputhje me DKU-në
- identifikimin zyrtar dhe klasifikimin e trupave ujorë (ndjekje e procedurave të përshkruara në këtë plan), përfshirë përcaktimin e statusit ekologjik të ujërave sipërfaqësore dhe statusin kimik dhe sasior të rezervuarëve të ujërave nëntokësore.
- vlerësimet e riskut për nxjerrjen e ujit nga zonat ujëmbajtëse në zonat bregdetare dhe vende të tjera ku gjendja sasore e ujërave nëntokësore mund të jenë në rrezik

Më poshtë japim një përmbledhje të atyre që ne i konsiderojmë si problematika kritike, të cilat aktualisht ndikojnë në statusin e basenit ujor.

Gjatë periudhës së këshillimit gjashtë mujor korrik 2020 - janar 2021, gjatë së cilës AMBU do të jetë gjithashtu duke hartuar Projekt Planin për Menaxhimin e Basenit Ujor, palët e interesit janë të ftuara të identifikojnë problematika të rëndësishme të mundshme që nuk janë të renditura në këtë Panoramë. AMBU do t'i përgjigjet këtyre çështjeve. Megjithatë, në kuadrin e transparencës së procesit të këshillimit, ftojmë palët e interesit të shqyrtojnë fillimisht dhe të japin komentet/sugjerimet e tyre lidhur me çështjet e paraqitura në Tabelën 1-1.

Përmbledhja nuk ka për qëllim të jetë një dokument shterues, por një përmbledhje e thjeshtuar për shqyrtim dhe komentim nga publiku i gjerë, dhe palët e interesit në sektorin e ujit, përpara hartimit dhe publikimit të një projekt Plani të Menaxhimit të Basenit Ujor më teknik dhe më gjithëpërfshirës, që duhet të botohet deri më shtator 2021.

Tabela 1-1 – Përmbledhje e Temave Kryesore të Menaxhimit të Ujërave

Tema kryesore	Komente mbi presionet, statusin ose ndikimet kryesore
<p>MJEDISI</p> <p>Ndryshimet klimatike dhe burimet ujore</p> <p>Sistemet e të dhënave hidrometeorologjike dhe monitorimit</p> <p>Zonat e Mbrojtura dhe Ekosistemet Ujore</p> <p>Përmbytjet dhe Thatësitrat</p> <p>Vazhdimesia dhe Morfologjia e kanalit lumor dhe fushes aluvionale</p>	<p>PROBLEMATIKA TË MUNDSHME</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ulje e pritshme e reshjeve nga 2,6 deri në 5,4% deri në vitin 2030 • Rritje e pritshme e temperaturës me 0,9-1,1 °C deri në vitin 2030. • Ulje e pritshme e prurjeve në lumenj nga 3,6 deri në 7,6% deri në vitin 2030 • Ulje e pritshme e prurjeve në lumenj nga 8,5 deri në 16% deri në vitin 2050 <p>Ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesë më e madhe për energji për ftohje. • Ulje të furnizimit me ujë. • Ulje të prodhimit të energjisë elektrike. • Probleme me cilësinë e ujit (kripëzimi dhe çelja e algave ujore). • Thatësitrat në verë dhe përmbytjet në dimër priten të përkeqësohen si pasojë e ndryshimeve klimatike. <ul style="list-style-type: none"> • Performancë që nuk përputhet me kërkesat e BE dhe mangësi në rrjetet e monitorimit të cilësisë së ujit. Të dhëna të pamjaftueshme hidrologjike (dhe meteorologjike). • Performancë që nuk përputhet me kërkesat e BE dhe mangësi në rrjetin e monitorimit të ujërave nëntokësore aktuale. • Të dhënat aktuale të monitorimit të cilësisë (përfshirë “statusin ekologjik” të DKU-së) dhe sa sasia e tyre (përfshirë “statusin hidromorfologjik të DKU-së) për burimet ujore nuk janë të mjaftueshme. Monitorimi dhe vlerësimi i statusit të burimeve ujore nuk është vetëm kërkesë në kuadrin e hartimit të PMBU-ve, por edhe për ndjekjen e rezultateve të zbatimit të programit dhe masave. • Cilësia e shumicës së ujërave nëntokësore është, në dukje, ende e mirë, por nuk ka të dhëna të mjaftueshme monitorimi për të vlerësuar ndotjen e mundshme me pesticide apo metale të rënda, apo edhe ndotës të tjerë. <ul style="list-style-type: none"> • Mospërcaktimi i duhur i kufijve dhe mbrojtja e papërshtatshme e burimeve të ujit të pijshëm • Shtatë zona të mbrojtura të përcaktuara sipas legjislacionit shqiptar dhe të vendosura brenda kufijve të Rajonit të Basenit të Matit • Hedhje e pakontrolluar e mbetjeve përgjatë brigjeve të lumit <ul style="list-style-type: none"> • Nuk janë hartuar Plane për Menaxhimin e Riskut nga Përmbytjet • Nuk janë hartuar Plane për Menaxhimin e Riskut nga Thatësira <ul style="list-style-type: none"> • Në pjesën e poshtme të rrjedhës në bashkimin e lumenjve Fan dhe Mat nxirren sasi të mëdha zhavorri nga shtrati i lumit. • Nxjerrja intensive e zhavorrit dhe rërës ndikon regjimet e prurjeve (përfshirë erozionin e brigjeve) dhe ekosistemet ujore. • Kaskadat e hidrocentraleve të mëdha (HEC-et) në Ulëz dhe Shkopet (kapacitet i instaluar prej 49 MW) kontrollojnë pjesërisht disponueshmërinë e ujit për përdorim më tej në rrjedhën e poshtme, si pasojë e funksionimit të rezervuarëve.

Prurja mjedisore

PËRDORIMI I UJIT

Përdorimi i Ujit, Marrja e Ujit dhe Leja për Marrje

Shkarkimet e Ujit, Ndotja e Ujit dhe Leja për Shkarkim

Digat dhe hidrocentralet

Përdorimi, mbrojtja dhe monitorimi i sistemeve nëntokesore

MENAXHIMI I VIJËS BREGDETARE

Cilësia e ujërave bregdetare, ujërat e plazheve, habitatet

Menaxhimi i vijës bregdetare, risku i përmblytjeve dhe erozioni

- Faktikisht, rrjedhat ekologjike të nevojshme, që mbështesin funksionimin e shëndoshë të ekosistemeve ujore, ndryshojnë në segmente të ndryshme të lumenjve/përrenjve dhe liqeneve/rezervuarëve. Përmblytjet janë përkeqësuar gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit si pasojë e shpyllëzimit, kullotjes së tepruar dhe erozionit, shoqëruar me mungesën e mirëmbajtjes së kanaleve të kullimit dhe stacioneve të pompave, si dhe regjimet e funksionimit të rezervuarëve.

PROBLEMATIKA TË MUNDSHME

- Shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve (UK) u ofrojnë shërbime ujësjellësi rreth 80 për qind të popullatës në zonat e tyre, duke mbuluar 90 për qind të popullatës në zonat urbane dhe 60 për qind në zonat rurale. Humbjet e ujit janë zakonisht të larta ose shumë të larta për shumicën e këtyre shoqërive.
- Humbjet e ujit janë zakonisht të larta ose shumë të larta për shumicën e këtyre shoqërive.
- Mungesa e kapaciteteve financiare dhe kapacitetet e kufizuara teknike të UK-ve rezultojnë në paqartësi sa i përket qëndrueshmërisë funksionale afatgjatë.
- Një sërë shpimesh ose pusesh të shpuara për furnizim privat me ujë dhe për përdorim industrial dhe bujqësor, janë vënë në funksion pa leje.
- Mungesë e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm që merret nga pusët private/vendore në zonat rurale.
- Aktualisht, në basenin e Matit nuk ka impiante për trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Supozohet që të gjitha mbetjet e lëngshme shkarkohen drejtpërsëdrejti në mjedis, por të dhënat e monitorimit mjaftojnë për të identifikuar ecurinë e cilësisë së ujit të lumit dhe për përcaktimin e prirjeve, veçanërisht sa i përket parametrave që ndryshojnë në bazë të stinës.
- Mbulimi i përgjithshëm me shërbime kanalizimesh mbetet diku rreth 51 për qind. Ka një dallim të konsiderueshëm midis zonave urbane dhe rurale.

- Rezervuarët, që përdoren për ujitje, hidrocentralet dhe/ose furnizimi me ujë të pijshëm, krijojnë trysni hidro-morfologjike, ndërkohë që qasja lidhur me to duhet të jetë ajo e “trupave ujorë tejet të modifikuar ose sipërfaqësorë artificialë”

- Nxjerrja e tepërt e pakontrolluar e ujërave nëntokesore
- Sistemi i monitorimit të cilësisë dhe sasisë i papërshtatshëm
- Rreziku për përmblytje të brigjeve detare nga ujërat e detit

PROBLEMATIKA TË MUNDSHME

- Disa nga kërcënimet kryesore për zonat bregdetare përfshijnë erozionin, peshkimin e tepruar, ndotjen dhe ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike.
- Parashikimet për ngritjen e nivelit të detit në masën 0,2 - 0,3 m deri në vitin 2050 mund të krijojnë risk të konsiderueshëm nga përmblytjet

- Rritja e nivelit të detit mund të rrisë trysinë depërtuese në ujërat nëntokësore

2. Mënyra e Projektimit të këtij Konsultimi

2.1 Temat Themelore

Tabela 1-1 përmbledh ato që AMBU i konsideron temat kryesore që mund të merren parasysh për klasifikimin e situatës aktuale në basenin e Lumit Mat. Ne kërkojmë komentet dhe sugjerimet e palëve të interesit për secilën prej këtyre çështjeve, me qëllim mbështetjen e hartimit të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor dhe ngritjen e programit të masave konkrete për trajtimin e të gjitha problematikave të identifikuara.

Megjithatë, me qëllim planifikimin e burimeve të nevojshme ekonomike për zbatimin e programit, do të ishte me vend të identifikoheshin përparësitë urgjente në secilën prej temave themelore, si dhe ato që mund të kërkojnë vëmendje më të detajuar në PMBU-të e ardhshme.

2.2 Përmbajtja e Temave dhe Metodologjia e Vlerësimit

Në pjesët 4 deri në 15, ofrojmë një përmbledhje të thjeshtë të problematikave kryesore për secilën nga temat themelore. Këto problematika janë identifikuar nga një sërë burimesh, përfshirë të dhënat zyrtare hidro-meteorologjike, programe të monitorimit mjedisor, studimet teknike të kryera nga universitete, operatorët dhe/ose konsulentët, agjencitë ndërkombëtare, si edhe grupet vendore aktive apo OJF-të. Në këtë fazë të hershme, të gjitha pikëpamjet dhe opinionet janë të rëndësishme, por ato do të duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi më rigoroz bazuar në prova në kuadrin e hartimit të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor.

Me qëllim përcaktimin e nevojës për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese apo parandaluese për një nga temat e përgjithshme apo nënbasenet, fillimisht do të përcaktojmë ndikimet e shkaktuara nga trysnia e njeriut, përmes një vlerësimi teknik. Në fund, do të përcaktojmë se cilat janë reagimet apo veprimet e duhura (programi i masave) që duhet të ndërmarrim për të:

- a) Ruajtur dhe mbrojtur qëndrueshmërinë e burimeve ujore, trupave ujqorë dhe ekosistemeve tona ujore;
- b) Siguruar që të gjitha ujërat përdoren në mënyrë efikase dhe produktive dhe në të njëjtën kohë pa dëmtuar mjedisin;
- c) Zbatuar kërkesat e ndryshme të legjislacionit kombëtar për ujin.


Gjendja e mjedisit mund të ndryshojë në pjesë të ndryshme të basenit ujor në varësi të trysnive, dhe kjo mund të krijojë sfidën e mundshme për qasje ose zgjidhje të ndryshme për zona të ndryshme.

Për këtë arsye, basenin ujor e kemi ndarë në njësi më të vogla hapësinore, të ashtuquajtura nënbasene, ku presim mbizotërimin e trysnive të ndryshme (dhe për pasojë dhe problematikave e zgjidhjeve të ndryshme). Së fundmi, në kuadrin e PMBU-së përfundimtare të miratuar, shkallën e analizës do ta zbresim deri tek trupat individualë ujqorë (lumenj, liqene, dhe ujërat nëntokësore), por për qëllimet e këtij konsultimi të parë do të përqendrohemi në temat e përgjithshme dhe nënbasenet kryesore brenda basenit ujor.

Qasja metodologjike në këtë përmbledhje (dhe ajo që do të përdoret për PMBU-në) është e ashtuquajtura metodë Forcat Shtytëse-Trysni-Gjendje-Ndikim-Përgjigje (FSTNGP) (Figura 2-1).

Si rrjedhojë, komentet tuaja gjatë konsultimit mund të trajtojnë çdonjërin (ose të gjitha) proceset ciklike që paraqiten në Figurën 2-1. Më së shumti, në një Plan për Menaxhimin e Basenit Ujor, përqendrohemi në gjendjen e ujërave tona dhe ndikimet, si dhe komentet për trajtimin e këtyre ndikimeve, por siç paraqitet në Figurën 2-1, reagimi/reagimet në nivelin drejtues mund të duhet të trajtojnë edhe problematika të niveleve më të larta, siç janë forcat shtytëse të ndryshimeve klimatike dhe/ose zhvillimit ekonomik, me qëllim lehtësimin e trysnive të identifikuara në nivel vendor.

Figura 2-1 – Metoda STNGP në Direktivën Kuadër të Ujit



2.3 Si mund t'i përgjigjem këtij Konsultimi?

Reagimet tona në nivel drejtimi (veprimet) gjatë programit të masave kanë gjasa të jenë shumë gjera. Disa prej tyre do të ndërmerren në nivel politikash dhe strategjik, disa mund të kërkojnë përmirësime të qenësishme në zbatimin e akteve ligjore apo monitorimit nga ana e autoriteteve të tjera kompetente, dhe të tjera akoma, do të jenë propozime masash teknike p.sh., për uljen e çuarjes së ujit dëm apo përdorimin e paautorizuar të ujit, përmirësimin e rrjedhave mjedisore ose zbatimin e pakësimit të ngarkesave të ndotësve nga veprimtaritë bashkiake ose industriale, përmes Lejeve kufizuese.

Vetë AMBU mund të rreket të vendosë këto kërkesa më strikte për përdorimin, monitorimin dhe raportimin e nxjerrjes së ujit dhe shkarkimeve nga ana e operatorëve, me qëllim kontrollin më të mirë të gjendjes apo ndikimeve në sektorin e ujit. Kjo është 'masë' po aq e vlefshme në kuadrin e programit të masave.

Në fund të çdo pjese, kemi përmbledhur problematikat kyçe që lidhen me çdo temë. Kemi përfshirë edhe një formular për përgjigjet nga ana e palëve të interesit si një **Shtojcë të veçantë të kësaj Përmbledhje**, ku ata mund të japin komentet dhe reagimet e tyre lidhur me çdonjërin prej problematikave, në kuadër të një grupi të paracaktuar pyetjesh. Në formular ka hapësirë ku mund të shtoni komentet apo vërejtjet e mëtejshme. Qëllimi është që publiku dhe operatorët kryesorë të shërbimeve të ujit të përdorin të njëjtin formular. Formulari i përgjigjeve në Shtojcë mund të shkarkohet si dokument më vete nga faja e internetit e AMBU-së.

Çdo palë interesi duhet të plotësojë disa informacione të thjeshta kontakti, në mënyrë që të kemi mundësi t'ju kontaktojmë më tej nëse është e udhës. Nëse keni ekspertizë teknike të qenësishme ose burime të dhënash që mund të jenë të dobishme dhe të japin kontribut për bazën e provave të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor, ju lutemi ta shprehni këtë në formularin e përgjigjes.

Një përmbledhje e përgjithshme e përgjigjeve të konsultimit do të botohet si shtojcë e Planit përfundimtar të Menaxhimit të Basenit Ujor. Konsultimi për këtë Përmbledhje do të mbyllet më **30 Janar 2021**.

Ky Konsultim dhe administrimi i përgjigjeve të konsultimit po kryhet nga AMBU, në cilësinë e autoritetit kompetent për hartimin e PMBU-ve në Shqipëri. Kjo Përmbledhje është në përputhje me Ligjin e Republikës së Shqipërisë për Konsultimin Publik, përkatësisht Neni 15 dhe Neni 17. Nëse keni pyetje lidhur me këtë Përmbledhje, ose nëse ju nevojiten sqarime për mënyrën e përgjigjes, mund të kontaktoni drejtpërsëdrejti me:

<emri>

<AMBU>

<Task forca e PMBU-së etj.>

<email>

<telefon>

2.4 Përmbledhje

Uji është jetik për jetën dhe për jetesën tonë. Në Shqipëri duhet të bëjmë punë serioze dhe të përmirësojmë mjedisin tonë ujqor. Ne duam të kemi:

- ujëra bregdetare dhe të brendshme më të pastra, pa ndotje dhe mbetje të ngurta;
- sisteme të shëndosha dhe të mbrojtura dhe rrjedha mjedisore për florën dhe faunën e egër që jeton në dhe përreth ujit;
- përdorim më efikas, të efektshëm dhe të qëndrueshëm të ujit si burim natyror;
- lumenj dhe liqene që janë tipare të vlerësuara të peizazhit tonë urban dhe rural;
- kontroll të veprimtarive të jashtëligjshme si nxjerrja e paautorizuar e zhavorrit, dhe hedhja e mbetjeve që shkatërrojnë mjediset e lumenjve tanë;
- aftësi ripërtëritëse të përmirësuara në lidhje me riskun nga përmbytjet.

3. Baseni Ujor i Matit

Pjesët në vijim paraqesin një arsyetim të shkurtër për nënndarjet e basenit ujor të Matit në nënbasene më të vogla. Pritet që në Programin e Masave që do të hartohet për secilin basen të mund të përfshihen objektiva dhe veprime të ndryshme të veçanta për secilin nënbasen, apo dhe për trupa ujorë individualë brenda këtyre nënbaseneve, në varësi të trysnive apo gjendjes së këtyre trupave ujorë, shkallës së ndikimit dhe realizueshmërisë së zgjidhjeve të efektshme gjatë periudhës së Planit.

Sipërfaqja e basenit të Matit në rrjedhën e sipërme të bashkimit me Lumi Fan në afërsi të Milotit është 1330 km². Baseni i Lumit Fan ka një sipërfaqe prej rreth 1080 km² dhe zona bregdetare që përfshin pjesën e lumit pas bashkimit të Lumit Fan në Detin Adriatik ka një sipërfaqe prej rreth 590 km². E gjithë zona e basenit ujor zë një sipërfaqe prej 2993 km². Duhet theksuar se lumarja bregdetare ka denduri relativisht të lartë popullore me ndikime akoma më intensive nga veprimtaria njerëzore se sa nga zona në brendësi të tokës. Por zona e bregdetare e basenit përfaqëson vetëm rreth 15 % të të gjithë zonës së Rajonit të Basenit të Lumit Mat.

Përroi kryesor i Lumit Mat është në Malin Kaptinë në një lartësi prej rreth 1870 m mbi nivelin e detit. E gjithë zona ujëmbledhëse e Lumit Mat ka sipërfaqe prej 2445 km² dhe një lartësi mesatare prej 746 m. Gjatësia e përgjithshme e Lumit Mat është 144 km.

Lumi Fan ka origjinën nga dy degë, Fani i Vogël dhe Fani i Madh.

Fani i Madh ka një zonë ujëmbledhëse prej rreth 540 km² dhe ka gjatësi prej rreth 77 km. Lartësia e mesme është rreth 700 m. Zona kryesore e burimit është në lartësi prej rreth 1400 m mbi nivelin e detit. Lugina e Fanit të Madh është rreth 60 km në gjatësi me drejtim nga verilindja në jugperëndim. Në pikën e bashkimit me Fanin e Vogël, lugina ndodhet në lartësi prej 180 m mbi nivelin e detit.

Zona ujëmbledhëse e Fanit të Vogël ka sipërfaqe prej 415 km² dhe Lumi ka gjatësi prej rreth 55 km. Zona ujëmbledhëse qëndron në një lartësi mesatare prej 734 m. Burimet e Fanit të Vogël gjenden në rreth 1860 m mbi nivelin e detit. Fani i Madh dhe Fani i Vogël bashkohen në afërsi të Rrëshenit.

Trupa të mëdhenj ujorë artificialë si rezervuarët e Ulzës dhe Shkopetit mund të shihen edhe si liqene, megjithëse nivelet e ujit të tyre luhaten shumë dhe zonat e bregut të tyre janë të gërryera.

Rezervuari më i madh nga të dy është ai i Ulzës, që është një digë artificiale e ndërtuar për prodhim energjie elektrike. Thellësia e liqenit luhatet gjatë vitit, por liqeni do të klasifikohet si i thellë, sepse mund të arrijë thellësi deri në 60 metra. Liqeni i Shkopetit ka një rezervuar me kapacitet rreth 6 milion metra kub.

Gjatë bregut ka disa laguna: Merxhan (300 ha), Kune (800 ha), Vain (1500 ha), dhe Patok (2200 ha).

Lagunat kanë tipare të ngjashme gjeomorfologjike me sedimente fundore të buta mbi argjilë të ngjeshur dhe material organik. Thellësitë e tyre luhaten midis 0,3 dhe 1,5m, kripësira është

15-40°/00, temperaturat luhaten nga 5 deri -32°C dhe matjet e oksigjenit japin shifrën 2,8 mg/l.

Këto laguna janë me vlerë për shkak të nivelit të lartë biodiversitetit, si dhe interesave ekonomike të lidhur me turizmin, peshkimin, gjuetinë, etj.

Baseni ujqor i Matit mund të përshkruhet lidhur me shkarkimin në 14 zona nënbasenesh hidrografike. Për qëllimet e menaxhimit të ujërave, këto nënbasene organizohen në 5 nënbasenet në vijim (Nënbasenet janë renditur duke filluar nga rrjedha e sipërme në atë të poshtme për qartësi):

Mati 2, (MA2)

Kriteri: Kriteri për përcaktimin e këtij nënbaseni është diga e hidrocentralit në Lumin Fani i Madh.

Sipërfaqja (km²): 534,841384

Mati 3, (MA3)

Kriteri: Kriteri për përcaktimin e këtij nënbaseni lidhet me përcaktimin e zonës ujëmbledhëse të Lumit Fani i Vogël.

Sipërfaqja (km²): 417,132317

Mati 4, (MA4)

Kriteri: Kriteri për përcaktimin e këtij nënbaseni lidhet me kriterin e gjeologjisë, sespe në këtë zonë ka përqendrim më të madh argjile, gurësh ranorë dhe konglomerate.

Sipërfaqja (km²): 790,651745

Mati 1, (MA1)

Kriteri: Kriteri për përcaktimin e këtij nënbaseni lidhet me bashkimin e lumenjve Mat dhe Fani.


Sipërfaqja (km²): 708,904581

Mati 0, (MA0)

Kriteri: Kriteri për përcaktimin e këtij nënbaseni lidhet me relievin, sepse në këtë nënbasen ka tipologji të ndryshme krahasuar me nënbasenet e tjera, për shkak se zona është relativisht e sheshtë me veprimtari bujqësore dhe urbane.

Sipërfaqja (km²): 357,615597

Figura 3-1 – Vendndodhja dhe nënbasetet e basenit ujq të Lumit Mat



4. Ndryshimet Klimatike dhe Burimet Ujore


4.1 Përse ka rëndësi kjo?

Skenarët e ndryshimeve klimatike për rajonin e Evropës Juglindore (shihni Figurën 4-1) tregojnë pakësim të përgjithshëm të reshjeve dhe rritje të temperaturave të ajrit, çka do të sjellë ulje të sasisë së burimeve ujore në vend. Pakësimi i të mesmes vjetore dhe stinore të reshjeve, së bashku me rritjen e të mesmes vjetore dhe stinore të temperaturave të ajrit mund të sjellë rënien e të mesmes vjetore dhe stinore të prurjeve në periudhën afatgjatë, duke pakësuar kështu rrjedhën e ujërave sipërfaqësore. Në kuadrin e rrjedhës së pakësuar të ujërave sipërfaqësore dhe rritjes së avullimit, kapaciteti i rezervuarëve mund të pakësohet, duke ndikuar sasinë e ujit të pijshëm dhe prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet.

Megjithëse pritet që të ketë një pakësim të përgjithshëm të reshjeve, ka gjasa të ketë edhe një rritje të episodeve me reshje të rrëmbyera. Shqipëria është një ndër vendet e ndikuara nga ndryshimet klimatike që do të përballet me ndikime mbi burimet e veta ujore, përfshirë edhe përmasat dhe shpeshësinë e ndodhive të përmytjeve katastrofike. Thatësirat në verë dhe përmytjet në dimër priten të përkeqësohen si pasojë e ndryshimeve klimatike.

Pakësimi i burimeve ujore do të shkaktonte ndryshime edhe në erozionin e shtretërve të lumenjve, dhe ndryshim të turbullirës dhe ngarkesës me sediment, duke kërcënuar kështu cilësinë e ujit. Pakësimi i rimbushjes së ujërave nëntokësore, rritja e kripësirës, shtimi i popullsisë dhe si pasojë rritja e kërkesës për ujë, ka gjasa të sjellin një pakësim të ujit të pijshëm në cilësinë dhe sasinë e përshtatshme. Megjithëse aktualisht disponueshmëria mesatare e ujit për qëllimet e ujit të pijshëm, i tejkalon kërkesat për volume uji në të gjitha zonat juridikionale të UK-ve, ka dallime të rëndësishme në disponueshmëri uji në bashki të ndryshme dhe humbjet e ujit janë të larta ose shumë të larta në shumicën e rasteve.

Figura 4-1 – Tregues të Ndikimeve të Ndryshimeve Klimatike për Evropën Jugore



Burimi: IPCC Raporti i 5-të i Vlerësimit, Grupi II i Punes, 2014

4.2 Problematikat aktuale

Tre komunikime kombëtare ¹ janë përgatitur veçanërisht për Shqipërinë në kuadrin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, të zbatuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Programi për Zhvillim i Konventa e Kombeve të Bashkuara. Rritja e temperaturave dhe pakësimi i reshjeve parashikohen të jenë të rënda, siç edhe ilustron në Figurën 4-2.

Figura 4-2 – Ndikimet e parashikuara të Ndryshimeve Klimatike 2025 - 2100

Skenarët për Shqipërinë		Shtirirja Kohore		
		2025	2050	2100
Dimër	temperatura (°C) /reshjet (%)	0.8+1.0	1.3+1.8	2.1+3.7
		-1.6+0	-1.8+0	-1.7+0
Pranverë	temperatura (°C) /reshjet (%)	0.7+0.9	1.0+1.5	1.8+3.0
		-2.7+-1.3	-3.6+-2.1	-7.4+-3.4
Verë	temperatura (°C) /reshjet (%)	0.9+1.2	1.2+2.0	2.3+4.1
		-8.0+-5.6	-20.0+-9.1	-27.0+-14.4
Vjeshtë	temperatura (°C) /reshjet (%)	0.9+1.1	1.1+2.0	2.1+3.8
		-4.3+-2.4	-11.2+-2.1	-16.2+-8.6
Vjetore	temperatura (°C) /reshjet (%)	0.8+1.0	1.2+1.8	2.1+3.6
		-3.8+-2.4	-6.1+-3.8	-12.5+-6.0
Niveli i Detit (cm)			20-24	48-61
Mbulimi me re (%)		-1.3+-1.5	-2.6+-2.0	-4.6+-3.1
Shpejtësia e Erës (%)		0.7	1+1.3	1.6+2.3

Burimi: Komunikimi i Parë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike

Studimet aktuale të kryera në fushën e ndryshimeve klimatike për Shqipërinë² tregojnë se ndodhitë ekstreme që janë intensifikuar gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, po ndikojnë ekonominë shqiptare. Në pikëpamjen afatgjatë, ndryshimet klimatike dhe ekstremet përkatëse mund të ndikojnë Shqipërinë duke sjellë ³ më pak reshje, ndryshime në shpërndarjen e reshjeve gjatë vitit, intensifikim të ndodhive ekstreme (përmbytje, thatësira), rritje të temperaturave dhe rritje të nivelit të detit.

- Shpeshtimi i ndodhive të motit ekstrem (reshjet e rrëmbyera, risqet nga përmbytjet e mundshme, erërat e forta, thatësirat)

¹ Komunikimi Kombëtar i Parë (2002), i Dytë (2009), i Tretë (2016) i Republikës së Shqipërisë për Ndryshimet Klimatike

² Sfidat Energjetike dhe Mjedisore ndaj sigurisë. Programi shkencor i NATO-s për paqe dhe siguri. Springer Verlag. ISBN 978-1-4020-9451-2009.

³ "Identifikimi dhe zbatimi i masave të përgjigjes për përshtatje në deltat e Lumit Drin-Mat" MSP GEF/UNDP, www.ccalb.org

- Pakësim i prurjeve vjetore dhe stinore, dhe ndryshime në shpërndarjen e reshjeve gjatë vitit.
- Rritje e temperaturës dhe rritje e nivelit të detit.

Ndikimi i ndryshimeve klimatike

Skenarët e ndryshimeve klimatike të hartuar për zonën që përfshin basenin e Matit parashikojnë se reshjet vjetore do të bien me 2,6-5,4% dhe temperaturat mesatare vjetore do të rriten me 0,9-1,1°C gjatë periudhës deri në vitin 2030. Supozimi është që ky ndikim të rritet gradualisht përgjatë të gjithë shekullit 21. Gjithashtu, pritet një reduktim i prurjeve të lumit nga 3,6 deri në 7,6% dhe nga 8,5 deri në 16% deri në vitin 2030 dhe 2050 përkatësisht. Ndikimi i ndryshimeve klimatike ka gjasa të ketë ndikime të rëndësishme në burimet e disponueshme ujore në periudhën afatgjatë deri në vitin 2100. Kjo mund të ndikojë negativisht në sektorin energjetik të Shqipërisë që aktualisht varet nga burimet ujore në një masë më të madhe se 90%.

Ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike përfshijnë:

- Kërkesë më e madhe për energji për ftohje.
- Ulje të furnizimit me ujë.
- Ulje të prodhimit të energjisë elektrike.
- Probleme me cilësinë e ujit (kripëzimi dhe çelja e algave ujore).

Për shkak të kolapsit virtual të sistemit efikas të monitorimit të rrjedhës së ujërave sipërfaqësore që prej vitit 2000 (shihni pjesën 5), aktualisht AMBU nuk është në gjendje të bëjë përlllogaritje të sakta sasiore të reshjeve vjetore dhe ndryshimeve përkatëse të disponueshmërisë së burimeve ujore për periudhën 1991-2020.

Në kuadrin e ‘emergjencës klimatike’ që nga shumë prej shkencëtarëve kryesorë të botës⁴, shihet si mbizotëruese aktualisht, është tejet e rëndësishme që autoritetet kombëtare kompetente në Shqipëri (veçanërisht AMBU, Ministria e Mjedisit dhe Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM)) të bashkërendojnë punën dhe të identifikojnë me saktësi prirjet aktuale dhe ndryshimet në burimet ujore në nivel baseni. Kjo kërkon mbledhjen dhe analizimin e të dhënave hidro-meteorologjike të kohëve të fundit dhe krahasimin e tyre me të dhëna historike të besueshme.

Përshtatja me ndryshimet klimatike

Strategjitë gjithëpërfshirëse për përballimin e ndikimeve të parashikuara të ndryshimeve klimatike janë trajtuar në Komunikimin e Tretë Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore dhe Programin Kombëtar Sektorial, si dhe në dokumente të tjera. Megjithatë, masat proaktive përkatëse nuk janë shqyrtuar ende. Disa nga pyetjet në këtë kuadër janë si më poshtë:

⁴ BioScience, 2019, “Lajmërimi i Shkencëtarëve Botërorë për një Emergjencë Klimatike”

- (i) si të veprimet për rritjen e numrit të rezervuarëve për të shtuar mundësitë kombëtare për prodhimin e energjisë përmes burimeve hidrike dhe/ose përballimin e kërkesave për ujë, kur rezervuarët ushtrojnë “trysni hidromorfologjike” të njohura (të mundshme) mbi ekosistemet ujore, dhe
- (ii) (ii) a duhet t’i paraprihet risqeve të përmytjes duke ngritur argjinaturat përgjatë segmenteve të përmytshme, duke krijuar/zgjeruar “zonat buferike” në brigje dhe/ose duke drejtuar regjimet e funksionimit të rezervuarëve?

4.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhen

Temperaturat e rritura dhe reshjet e pakësuara kanë gjasa të kenë ndikim masiv në burimet tona vjetore të ujërave të përdorshme në basenin ujor në 30 deri 50 vitet e ardhshme.

Në kuadrin e uljes së rrjedhës së ujërave sipërfaqësore dhe avullimit të shtuar, sasia e ujit të ruajtur në rezervuarë çdo vit do të pakësohet, çka do të thotë se do të ketë më pak ujë për njerëzit, prodhim të energjisë elektrike dhe bujqësi, veçanërisht gjatë muajve kritikë të verës (të thatë). Furnizimi i ujërave nëntokësore ka gjasa të ndikohet nga depërtimi më i pakët i ujërave sipërfaqësore, për shkak të rënies së volumit të reshjeve, rrjedhës dhe humbjes së lagështirës së tokës si pasojë e avullimit dhe transpirimit të shtuar.

Pakësimi i furnizimit me ujëra nëntokësore kombinuar me rritjen e mundshme të kripësisë së ujërave nëntokësore si pasojë e rritjes së nivelit të detit, mund të krijojë mungesa të furnizimit të duhur me ujë të pijshëm në ato vende ku ujërat nëntokësore janë burime parësore, si p.sh. në zonat bregdetare.

Autoritetet kompetente përgjegjëse për monitorimin hidrometeorologjik duhet të përmirësojnë urgjentisht shtrirjen dhe disponueshmërinë e të dhënave të lidhura me ndryshimet klimatike me qëllim përmirësimin e saktësisë së vlerësimeve vendore.

4.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 4-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Ndryshimet Klimatike dhe Burimet Ujore	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Nevoja për të përcaktuar nëse ndryshimet klimatike kanë pakësuar ndjeshëm sasinë e reshjeve dhe burimet ujore në basenin ujor të Matit në periudhën 1960-2018	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkërendimi i një studimi teknik për llogaritjen e prirjeve afatgjata të sasisë së reshjeve në nivel vendor. Përcaktimi i sasinë së mesme të reshjeve vjetore për periudhën 1961-1990 kundrejt periudhës 1991-2020. • Përgatitja e bilanceve të përditësuara dhe të besueshme të ujit në nivel nënbaseni.
Monitorimi meteorologjik në basenin ujor duhet të përmirësohet urgjentisht. Të dhënat janë të pamjaftueshme në lartësi >800m.	<ul style="list-style-type: none"> • duhet të përcaktohen burime të mjaftueshme buxhetore dhe njerëzore për ngritjen dhe mirëmbajtjen e një sërë stacionesh monitorimi meteorologjik (reshje, rrezatim diellor, etj.) në

	basenin ujq për të siguruar përmirësimin e shpejtë të cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave.
Të dhënat faktike për funksionimin e rezervuarëve (veçanërisht volumet e ujit të lëshuara), nëse ato ekzistojnë, nuk janë vënë në dispozicion.	<ul style="list-style-type: none"> Duhet të vihen në dispozicion të dhëna si ato për parashikimin e përmytjeve, përlogaritjen e bilanceve ujore dhe monitorimin e risqeve të mundshme të ndryshimeve klimatike.

5. Të Dhënat Hidrometeorologjike dhe Rrjetet e Monitorimit

5.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme?

Të dhënat hidrologjike (dhe meteorologjike) kanë rëndësi, për shembull, në kuadrin e shpërndarjes së ujit, parashikimit të përmytjeve, administrimit të thatësirave, prurjeve ekologjike dhe ndryshimeve klimatike.

Pa monitorim të mjaftueshëm dhe të besueshëm që kap dinamikën e sasisë së ujit në lumenj dhe përcakton prirjet hidrometeorologjike, veçanërisht sa i përket parametrave që ndryshojnë sipas stinëve, AMBU nuk mund të ndërmarrë vlerësime kuptimplota të disponueshmërisë së burimeve ujore dhe të vlerësojë, nëse këto burime janë nën trysni (pra nëse ato po përdoren më tepër seç duhet).

Matja dhe menaxhimi i sasisë ujore është tejet i rëndësishëm për vlerësimin e përdorimit afatgjatë të qëndrueshëm të ujit. Matjet e sakta të reshjeve dhe prurjes përkatëse të basenit ujor janë jetike për përcaktimin e sasisë dhe menaxhimin e rimbushjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe për vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve klimatike. Përcaktimi i saktë i prurjeve natyrore varet nga matja e saktë historike e prurjeve.

5.2 Problematikat Aktuale

Në bazë të përvojës aktuale dhe raporteve teknike bazuar në informacion^{5 6}, rrjeti kombëtar hidrometeorologjik është pranë gjendjes së kolapsit për shkak të buxhetit, personelit dhe burimeve të pamjaftueshme. Rrjeti kombëtar meteorologjik është i dendur me 121 pikat e veta të monitorimit. Megjithatë, thuhet më shumë se 50% e tyre nuk përkrijnë me qëllimin, veçanërisht sa i përket matjes së temperaturës dhe/ose reshjeve, duke mos arritur të bëjnë matje, ose duke bërë matje me gabime të konsiderueshme. Vetëm 22% e stacioneve meteorologjike në Shqipëri janë të pajisura për monitorimin e reshjeve të borës, megjithëse ky është një element kritik për rimbushjen gjatë muajve të dimrit dhe të pranverës. Elementet e cilësisë hidrometeorologjike nuk monitorohen ende.

Autoriteti kompetent përgjegjës për monitorimin hidrometeorologjik në basenin ujor është kryesisht Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), por edhe Shërbimi Meteorologjik Ushtarak (SHMU) ka vënë gjithashtu në funksion 13 stacione meteorologjike sinoptike, të cilat vlerësohen të jenë në gjendje më të mirë funksionimi.

Aktualisht në basenin ujor të Matit nuk ka prova për funksionimin e saktë të asnjë prej 8 stacioneve ekzistuese të monitorimit hidrometrik (të vendosura në Breg, Bukmir, Ndërfan, Rubik, Milot, Shoshaj, Shkopet dhe Uraka).

⁵ Banka Botërore 2015 - Për krijimin e platformës institucionale dhe rregullatore për qeverisjen dhe funksionimin (IRP) të Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore në Shqipëri

⁶ Organizata Botërore e Meteorologjisë (WMO) (2019) - Raporti i Kontrollit të Cilësisë dhe Homogjenizimit të të dhënave klimatike nga Shqipëria për projektin PRO NEWS

Kur IGJEUM iu kërkuan të dhënat e prurjeve për këto Stacione, ato u vunë në dispozicion vetëm për periudhën 1960/70 deri në 1992. Nuk ka të dhëna të përdorshme për prurjet pas vitit 1992, në shumicën e stacioneve hidrometrike në Shqipëri.

Të dhënat për këto stacione janë të disponueshme deri në vitin 1985. Gjatë periudhës 1951-1985 Mati kishte të mesme shkarkimesh vjetore në masën e 103 m³/s, nga të cilat 60 m³/s e kishin origjinën nga vetë baseni ujqor i Matit dhe 43 m³/s vinin nga baseni i Fanit. Infiltrimi i ujërave nëntokësore përfaqësonte 30% të prurjeve vjetore, ndërsa rrjedhja sipërfaqësore përfaqësonte 70%. Prurjet e tij maksimale lidheshin me reshjet dhe shkërrjen e borës. Prurjet maksimale që ndodhin një herë në 100 vjet ishin të përmasave 3100 m³/s.

Shkarkimi specifik që vinte si rezultat ishte rreth 40 l/s.km² dhe koeficienti i rrjedhës ishte 0,75. Këto vlera zbatohen për lumenjtë Mat dhe Fan. Disa nga karakteristikat bazë janë ato që renditen më poshtë:

- volumi vjetor i shkarkimit: 3.250 milion m³,
- Rrjedha specifike për zonën: 40 l/s për km²,
- raporti midis muajit më të lagësht (dhjetor) dhe atij më të thatë (gusht) është përafërsisht 10.
- prurjet e mëdha një herë në 10 vjet i kalojnë prurjet mesatare me një faktor 25
- kapaciteti ujëmbajtës i rezervuarit të Ulzës ishte rreth 240 milion m³, (rreth 15% e prurjeve vjetore të Matit).

5.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Dështimi i rrjetit hidro-meteorologjik në të gjithë basenin do të thotë që nuk mund të kryhet identifikimi i saktë i burimeve ujore të basenit, duke kërcënuar kështu konsiderueshëm rëndësinë dhe dobinë e këtij PMBU-je.

Në veçanti:

- Strategjia e menaxhimit të burimeve ujore në nivel baseni (për përcaktimin e balancave aktuale ujore të basenit ujore, burimet aktualisht të disponueshme, rimbushjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore) nuk mund të përfundojë në mënyrë kuptimplotë.
- Plani i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet (PMRP) në nivel baseni nuk mund të hartohet në përputhje me Direktivën 2007/60/KE ⁷ të BE-së.
- Plani i Menaxhimit të Riskut nga Thatësira (PMRT) në nivel baseni nuk mund të hartohet në përputhje udhëzimet e BE-së.
- Gjendja ekologjike e trupave ujorë në basenin ujqor (që varet kritikisht nga regjimi i prurjeve) nuk mund të përcaktohet saktë në përputhje me Direktivën 2000/60/KE ⁸.

Degradimi i një sistemi monitorimi hidrometeorologjik efikas (ku burimet ujore kombëtare nuk janë matur apo analizuar saktësisht për thujse 30 vjet) ngre problematika të

⁷ Direktiva e Komisionit Evropian 2007/60/EC për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve të përmbytjes

⁸ Direktiva e Komisionit Evropian 2000/60/EC Direktiva Kuadër e Ujit

rëndësishme, sepse AMBU nuk është në gjendje të kryejë funksionin e vet kyç të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe të shpërndarjes sektoriale të ujit.

Ka nevojë për një riorganizim madhor institucional lidhur me mënyrën si mbliidhen, analizohen dhe vihen në dispozicion të dhënat hidrometeorologjike për agjencitë e tjera qeveritare apo institucionet profesionale. Një kuptim dhe përcaktim sasior i burimeve ujore kombëtare varet nga të dhëna tërësisht të sakta dhe të vazhdueshme, kështu që rrjetet hidro-meteorologjike kombëtare duhet të konsiderohen si çështje të rëndësishme kombëtare.

Të dhënat e reshjeve dhe prurjeve mujore duhet të jenë vazhdimisht të disponueshme për të gjitha palët e interesuara përmes një sistemi në internet si Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore, që në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk është ende tërësisht funksionale.

5.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 5-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Të Dhënat Hidro-meteorologjike dhe Rrjetet e Monitorimit	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Vështirësi ekstreme në marrjen e të dhënave të vlefshme dhe të përdorshme për prurjen nga Instituti i Gjeoshkencave.	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i një Memorandumi Mirëkuptimi për ofrimin e rregullt të të dhënave për cilësinë (niveli i reshjeve, prurjes, ujërave nëntokësore) në formën e të dhënave të përmbledhura, p.sh.: 6-mujore Të dhëna të përmbledhura (e mesme mujore) që do të ruhen në kadastrën e ujit
Mosfunksionimi i mundshëm i pjesës dërrmuese të sistemit për monitorimin e prurjeve në basenin ujor që prej vitit 1990 për shkak të mungesës së stafit dhe të burimeve. Sasia e ujit dhe burimet ujore, si dhe uji i disponueshëm për përdorim nuk mund të përcaktohet për asnjë trup ujor.	<p>Kërkohej një ndryshim madhor strukturor për përgjegjësinë dhe ofrimin e këtij shërbimi kritik kombëtar.</p> <ul style="list-style-type: none"> Ngritja e problematikës në nivelin më të lartë politik Financimi i mjaftueshëm i njësive të duhura Ringarkimi i përgjegjësisë së monitorimit të prurjeve agjencisë së përshtatshme alternative, si p.sh. Ministrisë së Mjedisit?
Nuk ka të dhëna për prurjet për asnjë lum që prej vitit 1992. Vlerësimet aktuale të menaxhimit bazohen në të dhëna vlefshmëria e të cilave ka përfunduar përpara 28 vjetësh. Përlllogaritjet për ndryshimet aktuale klimatike, burimet dhe rrjedhat natyrore nuk kanë kuptim.	<ul style="list-style-type: none"> Stacionet kritike për matjen e prurjeve duhet të rehabilitohen urgjentisht dhe të vihen në funksion nga Agjencia Shtetërore kompetente.

<p>Gjendja ekologjike e trupave ujorë nuk mund të përcaktohen në mënyrë kuptimplotë, sepse prurjet janë një përbërës jetik i statusit, sipas Direktivës 2000/60/KE të BE-së.</p>	<ul style="list-style-type: none">• Stacionet kritike për matjen e prurjeve duhet të rehabilitohen urgjentisht dhe të vihen në funksion nga Agjencia Shtetërore kompetente.
--	---

6. Zonat e mbrojtura dhe Ekosistemet ujore

6.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme?

Sipas legjislacionit të BE-së, një zonë e mbrojtur është një zonë gjeografike e përcaktuar qartë, e cila është e përkushtuar për arritjen e konservimit afatgjatë të natyrës. Kategoritë e menaxhimit të zonave të mbrojtura të BNRN i klasifikojnë zonat e mbrojtura sipas objektivave të tyre të menaxhimit.⁹ Në shkallë BE-je, përmes Direktivave të Zogjve dhe Habitaveve, u krijua rrjeti Natura 2000. Qëllimi kryesor është të sigurojë konservimin e specieve dhe habitateve të synuara dhe me interes evropian.¹⁰ Rrjeti Emerald i BE-së është një rrjet ekologjik i përbërë nga Zona me Interes të Veçantë Konservimi. Objektivi është mbijetesat afatgjatë e specieve dhe habitateve të Konventës së Bernës, të cilat kërkojnë masa të veçanta mbrojtjeje.¹¹

Në kuadrin e Direktivës Kuadër për Ujit të Be-së, (Shtojca IV) “Zonat e Mbrojtura” përfshihen edhe:

- zonat e përcaktuara për nxjerrjen e ujit për qëllime të konsumit njerëzor.
- zonat e përcaktuara për mbrojtjen e specieve ujore me rëndësi ekonomike.
- trupat ujorë të përcaktuar si ujëra për zbavitje, përfshirë zonat e përcaktuara si ujëra plazhi sipas Direktivës 76/160/KKE.
- zonat e ndjeshme ndaj ushqyesve, përfshirë zonat e përcaktuara si zona të cenueshme sipas Direktivës 91/676/KKE dhe zonat e përcaktuara si zona të ndjeshme sipas Direktivës 91/271KKE.
- zonat e përcaktuara për mbrojtjen e habitateve apo specieve ku mirëmbajtja ose përmirësimi i statusit të ujit është faktor me rëndësi për mbrojtjen e tyre, përfshirë sitet përkatëse të Natura 2000 të përcaktuar sipas Direktivës 92/43/KEE dhe Direktivës 79/409/KKE.

6.2 Problematikat Aktuale

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti kompetent për menaxhimin e sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura në Shqipëri. Puna për menaxhimin e siteve të Natura 2000¹² ka nisur vetëm kohët e fundit.

Gjashtë zona të mbrojtura të përcaktuara sipas legjislacionit shqiptar dhe të vendosura brenda kufijve të Rajonit të Basenit të Matit.

⁹ <https://www.iucn.org/theme/protected-areas/about/protected-area-categories>

¹⁰ Komisioni Evropian - https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/index_en.htm

¹¹ Këshilli i Evropës - <https://www.coe.int/en/web/bern-convention/emerald-network>

¹² BE - Forcimi i Kapaciteteve Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës – Përgatitja për Rrjetin Natura 2000, Mars 2019

Qasja për përcaktimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura në Shqipëri përshkruhet në Ligjin për Zonat e Mbrojtura¹³. Ligji përcakton mbrojtjen e gjashtë (6) kategorive të zonave të mbrojtura. Kategorizimi i zonave, statusi dhe shkalla e mbrojtjes që çdo zonë bazohen të kriteret e Qendrës Botërore të Konservimit të Natyrës.

Zonat e mbrojtura ekzistuese në kufijtë e rajonit të basenit të matit janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabelë: Zonat e Mbrojtura në Basenin Ujor të Matit

Emri i Zonës	Vendndodhja (rajoni)	Kategoria ¹⁴	Sipërfaqja (ha)
Bjeshka e Oroshit	Mirditë	VI	4,700
Lurë	Dibër	II	1,280
Berzanë	Lezhë	IV	880
Patok-Fushë Kugë	Kurbini	IV	2,200
Qafë Shtamë	Krujë	II	2,000
Kune	Lezhë	IV	800
Vain	Lezhë	IV	1,500

Sistemi shqiptar i zonave të mbrojtura po përballet me sfida të rëndësishme të krijuara nga shkalla e ulët e investimeve në infrastrukturën e zonave të mbrojtura, mungesa e pajisjeve dhe nevoja për kapacitete të përmirësuara teknike të stafit. Rugët e reja dhe infrastruktura, digat, hidrocentralet, rezervuarët e naftës dhe infrastruktura e turizmit masiv kërcënon seriozisht mbrojtjen mjedisore.

6.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Furnizimi me ujë të pijshëm në basen vjen kryesisht nga përrenjtë natyrorë dhe burimet e ujërave nëntokësore. Një shqetësim i veçantë për AMBU-n dhe Autoritetin Rregullator të Ujit (AKU), është hartëzimi jo tërësisht i saktë i burimeve që përdoren për ujin e pijshëm dhe mungesa e përgjithshme e pikave të nxjerrjes. Ka nevojë urgjente të hartëzohen dhe të përcaktohen zonat e mbrojtjes për burimet/përrenjtë kryesorë që përdoren për qëllimet e furnizimit me ujë të pijshëm.

Funksionimi i mirë i ekosistemeve (ujore) shihet si maja e menaxhimit të burimeve ujore. Sa i përket cilësisë së ujit, përdorimi/funksionet antropogjenike të ujit janë të mbrojtura në kuadrin e funksionimit të mirë të ekosistemeve ujore. Megjithatë, kur bëhet fjalë për sasinë e ujit “kërkesat ekologjike” mund të bien ndesh me përdorimet antropogjenike të ujit.

¹³ Ligji nr. 8906. Ligji për zonat e mbrojtura, datë 06.06.2002.

¹⁴ Sipas ligjit, zonat e rëndësishme ose ato në rrezik degradim shpallen zona të mbrojtura, sipas kategorive të mëposhtme të menaxhimit (BNMN, 1994):

- Kategoria I: Rezervate natyrore/rezervate shkencore strikte
- Kategoria II: Parqe Kombëtare
- Kategoria III: Monumente Kombëtare
- Kategoria IV: Rezervatet e menaxhimit të natyrës/zonat e menaxhimit të habitateve dhe specieve
- Kategoria V: Peizazhet e Mbrojtura
- Kategoria VI: Zonat e mbrojtura për menaxhimin e burimeve natyrore/zonat e mbrojtura të përdorura për qëllime të shumëfishta.

Nga njëra anë, ka nevojë urgjente për të vlerësuar me saktësi regjimet e prurjes natyrore në ato ekosisteme ujore ku këto prurje apo kushtet morfologjike janë kritike për statusin ekologjik të trupave ujorë, ndërsa nga ana tjetër është e nevojshme të ndërmerren veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre rrjedhave dhe parandalimin e shkatërrimit të ekosistemit ujor, dhe vijimësisë së habitatit të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme/të qenësishme nga nxjerrja e zhavorrit dhe/ose veprimtari të tjera minerare.

Në mënyrë që vlerësimi i statusit ekologjik të trupave ujorë të kryhet në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit 2000/60/KE, janë të nevojshme anketimet e trupave ujorë dhe procedura kombëtare standarde për identifikimin e kushteve biologjike referencë.

6.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 6-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Zonat e Mbrojtura dhe Ekosistemet Ujore	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Risqet e rëndësishme afatshkurtra ndaj furnizimit me ujë të pijshëm nga burime nëntokësore nga zhvillimet e papërshtatshme urbane	AMBU të punojë me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për hartimin dhe përcaktimin e zonave zyrtare të mbrojtjes për ujërat nëntokësore që duhet të bëhen pjesë e kuadrit të planifikimit urban
Risqe të rëndësishme afatgjata ndaj furnizimit me ujë të pijshëm nga burime nëntokësore nga zhvillimet e papërshtatshme rurale dhe bujqësore, përfshirë përdorimin e pakontrolluar të plehrave.	AMBU të punojë me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për hartimin dhe përcaktimin e zonave zyrtare të mbrojtjes për ujërat nëntokësore që duhet të bëhen pjesë e kuadrit të planifikimit rural. Parashikime afatgjata për kërkesën dhe ofertën e ujit në basenin ujor, duke marrë parasysh pakësimin e burimeve ujore (ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore) parashikuar sipas skenarëve të ndryshimeve klimatike të hartuara për zonën.
Risku ndaj siteve me interes të veçantë shkencor, specieve endemike dhe ekosistemit ujor, pa identifikimin e duhur të trupave ujorë me vlerë ekologjike.	AMBU dhe AKZM të bashkërendojnë anketimin dhe hartëzimin e siteve me rëndësi ekologjike për të përcaktuar sasinë dhe për të kufizuar trysnitë, si dhe për të identifikuar zonat e mbrojtjes për këta trupa ujorë.
Kushtet biologjike bazë të trupave ujorë nuk janë vlerësuar saktë për shumicën e trupave ujorë në Shqipëri. Gjendja ekologjike e të gjithë trupave ujorë aktualisht nuk po përcaktohet në përputhje me Direktivën 2000/60/KE.	AMBU dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) duhet të bashkërendojnë punën për të filluar anketimet dhe për hartimin e procedurave standarde kombëtare për përcaktimin e kushteve bazë për llojet standarde të trupave ujorë në Shqipëri.
Kriteret për status të mirë ekologjike, kimike dhe sasiore nuk	Vlerësimi i statusit ekologjik për përputhje me DKU-në mund të konsiderohet si sfida më e ndërlikuar për

<p>janë përcaktuar për trupat ujorë specifike, si sfond për ndërmarrjen e vlerësimeve të riskut. Kalibrimi i ndërsjellë me vendet fqinje (në të njëjtin rajon ekologjik) lidhur me statusin e mirë ekologjike nuk është ndërmarrë. E fundit por jo nga rëndësia, metodat, burimet dhe procedurat e menaxhimit në përputhje me kërkesat e DKU-së nuk janë përcaktuar mjaftueshëm ose nuk janë zbatuar.</p>	<p>programet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore. Duhet të shpërndahen dhe të vihen në dispozicion buxhete të përshtatshme për të mundësuar monitorimin dhe vlerësimin e statusit të ujërave sipërfaqësore, ujërave bregdetare dhe trupave të ujërave nëntokësore, në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit të BE-së (DKU).</p> <p>Duhet të hartohen Skema që përputhen me DKU-në për vlerësimin e statusit të ujërave sipërfaqësore, ujërave bregdetare dhe trupave të ujërave nëntokësore.</p>
<p>Lejet për marrjen e zhavorrit si ato të nxjerra në pjesën e shtratit të lumit në rrjedhën e poshtme të Lumit Mat, në shumicën e rasteve nuk bazohen në VNM që përcaktojnë masa kushtëzuese lehtësimi për mirëmbajtjen e statusit ekologjik në trupat ujorë.</p>	<p>Çdo ndërtesë apo projekt infrastrukturor madhor në sektorët e ekonomisë që mund të shkaktojë ndikime në statusin ekologjik të trupave ujorë duhet të ketë detyrimin e aplikimit për vlerësim të ndikimeve mjedisore për marrjen e lejeve, në ato raste kur do të ndërmerren masa lehtësuese mjedisore.</p>

7. Përmbytjet dhe Thatësitrat

7.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme?

Parashikimet e IPCC-së për ndryshimet klimatike tregojnë se shpeshtia dhe intensiteti i mundshëm i përmbytjeve dhe thatësirave do të rritet në të gjithë botën në të ardhmen.¹⁵ Në dhjetëvjeçarët në vijim risku i përmbytjeve në Evropë dhe dëmet ekonomike kanë gjasa të jenë më të larta.

Përmbytjet janë një problem i shpeshtë që ndodh midis nëntorit dhe marsit, kur ndodhin rreth 80% e reshjeve vjetore. Përmbytjet kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e komuniteteve vendore, duke shkatërruar shtëpitë e tyre dhe duke përkeqësuar gjendjen e tyre ekonomike. Duke shkaktuar dëme të rëndësishme në toka bujqësore dhe duke ndërprerë shërbimet e furnizimit me ujë të pijshëm, përmbytjet rrisin risqet shëndetësore dhe mund të dëmtojnë seriozisht llojet të ndryshme infrastrukture.

Përmbytjet janë përkeqësuar gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit si pasojë e shpyllëzimit, kullotjes së tepruar dhe erozionit, shoqëruar me mungesën e mirëmbajtjes së kanaleve të kullimit dhe stacioneve të pompave, si dhe regjimet e funksionimit të rezervuarëve. Shqipëria është një ndër vendet e ndikuara nga ndryshimet klimatike që do të përballet me ndikime mbi burimet e veta ujore, përfshirë edhe përmasat dhe shpeshtinë e ndodhive të përmbytjeve katastrofike.

Mbrojtja nga përmbytjet përfshin parandalimin e përmbytjeve, paralajmërimin e hershëm, minimizimin e dëmeve dhe dëmtimit për shkak të përmbytjes dhe përgjigjen në raste emergjence. Vendimet për planifikimin e projekteve, projektimin e projekteve dhe metodat e ndërtimit duhet të marrin në konsideratë shkallën e rrezikut të përmbytjeve të lumit.

Mungesa e ujit dhe përmbytjet janë fenomen gjithmonë e më i shpeshtë dhe i përhapur në Bashkimin Evropian.

Pritet që thatësitrat gjatë verës të përkeqësohen në Shqipëri si pasojë e ndryshimeve klimatike. Prurjet natyrore, që janë të nevojshme për mirëmbajtjen e gjendjes së ekosistemeve kërcënohen paralelisht nga ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe nga zhvillimet socio-ekonomike.

Periudhat me thatësira ndikojnë më fuqishëm në prodhimin bujqësor duke krijuar vështirësi ekonomike për fermerët, por edhe duke ndikuar në furnizimin me ujë nga ana e njësive vendore. Çekuilibrimi afatgjatë që vjen si pasojë e kërkesës për ujë që tejkalon burimet ujore, nuk është më fenomen i rrallë. Si pasojë, është e rëndësishme të pakësohet nxjerrja gjatë periudhave me prurje të pakta (verë), me qëllim mirëmbajtjen e funksioneve të ekosistemeve. Lidhja e drejtpërdrejtë midis ujit, mjedisit natyror, strukturës dhe funksionit të habitateve i detyron përdoruesit e ujit të menaxhojnë burimet e tyre në mënyra që mbrojnë, dhe kur është e mundur, rrisin mundësinë e mirëmbajtjes dhe rehabilitimit të biodiversitetit.

7.2 Problematikat Aktuale

Përmbytjet janë problem i shpeshtë në Basenin e Lumit Mat.

¹⁵ Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) 2014 - Ndryshimet Klimatike 2014 - Raporti Sintezë

Shqyrtimi i regjistrave dhe vëzhgimeve tregon se ka pasur shtatë përmbytje të mëdha gjatë 150 viteve të fundit in vitet 1854, 1860, 1905, 1937, 1962-63, 1970-71 dhe 1992. Përmbytjet e 1962-63 renditen të tretat në këtë listë, dhe duket se ato rikthehen rreth çdo 50 vjet. Gjatë përmbytjeve të vitit 1962-1963 një sipërfaqe prej 8 000 ha në basenin e Lumit Mat u përmbyt për 10 ditë me radhë.

Përmbytjet e mëdha në ultësirën bregdetare si pasojë e kombinimit të reshjeve të dendura, fryrjes së ujërave të detit nga stuhitë dhe baticat, kanë qenë më të shpeshta veçanërisht gjatë 15 viteve të fundit. Intensifikimi i këtyre ndodhivë vlerësohet si tregues i ndryshimeve klimatike në Shqipëri¹⁶. Ato kanë sjellë dëme në infrastrukturë, në sistemet e pompave të kullimit (p.sh., në shtator 2002), bujqësi, etj. Erozioni bregdetar ka qenë më agresiv. Një tjetër përmbytje e madhe në ultësirën bregdetare dhe grykën e Basenit të Matit ndodhi në janar të vitit 2010. Ngjarja ishte rezultat i tërheqjes së lumit si pasojë e ko incidencës së baticave shumë të mëdha, erërave të forta nga perëndimi të kombinuara me prurjet e mëdha të Lumit Mat, por që nuk ishin në vlera përtej atyre të zakonshme për Lumin në atë periudhë kohe.

Shkaqet kryesore të përmbytjeve ekstreme janë karakteristikat morfologjike dhe kushtet klimatike (shirat ciklonikë, të cilët paraprihen nga stuhi frontesh) në zonë. Duhet shtuar se efektet e kushteve klimatike negative ndonjëherë përkeqësohen nga kanalet e ujërave të larta të mirëmbajtura dobët dhe/ose nga mosfunksionimi i stacioneve të pompave (si në rastin e përmbytjes së shtatorit të vitit 2002), të cilat nuk arrijnë të kullojnë siç duhet ujërat e shirave.

7.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Mbrojtja nga dhe lehtësimi i përmbytjeve është një çështje madhore. Për këtë arsye, jemi të mendimit se në përputhje me kërkesat e Direktivës së BE-së 2007/60/KE, kuadri i menaxhimit të riskut nga përmbytjet duhet të jetë pjesë e një Plani me të gjerë dhe të një niveli më të lartë të Menaxhimit të Basenit Ujor. Në praktikë, kjo do të thotë se PMBU-ja duhet të përmbajë një Vlerësim Paraprak të Riskut nga Përmbytjet (VPRP) të ndërmarrë bazuar në informacionin e disponueshëm dhe lehtësisht të mundësueshëm mbi përmbytjet që kanë ndodhur në shkuarën, me qëllim identifikimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet e ardhshme. Megjithatë, mungesa e të dhënave të besueshme dhe të kohëve të fundit hidro-meteorologjike, është problem i qenësishëm për hartimin e Vlerësimeve kuptimplota Paraprake të Riskut nga Përmbytjet.

Zbatimi i masave të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të përshtatshëm, bazuar në një analizë me shumë kriteret dhe në bashkëpunim të ngushtë me projektet/programet që po zbatohen, mund të pakësojë efektet e përmbytjeve. Këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Identifikimin e gjendjes së digave dhe përmirësimin e sistemeve të kullimit dhe kanaleve për ujërat e fryra, veçanërisht rritjen e kapacitetit të stacioneve të pompave; dhe eventualisht ndërtimin e strukturave të reja në të dy brigjet e lumit;
- Pakësimin e erozionit përmes pyllëzimit, ndërtimit të digave të vogla në pjesën e sipërme të përrrenjve malorë;

¹⁶ Projekti "Identifikimi dhe zbatimi i masave të përgjigjes Përshtatëse në deltat Drinit dhe Matit" MSP GEF/UNDP, www.ccalb.org

- Zbatimin e një Shërbimi për Paralajmërimin e Përmytjeve me qëllim lajmërimin e popullatave lidhur me situata të mundshme rreziku.

7.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 7-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Përmytjet dhe Thatësitrat	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Përmytja historike e zonave urbane dhe rurale është çështje e njohur.	Duhet të hartohen Vlerësimet Paraprake të Riskut nga Përmytjet për zonat e njohura për përmytje. Duhet të hartohen Planet e Menaxhimit të Riskut nga Përmytjet për zonat me Risk të Mundshëm të Lartë nga Përmytjet.
Mungesa e të dhënave hidro-meteorologjike të kohëve të fundit parandalon analizën e shkaqeve dhe zgjidhjeve për përmytjet dhe thatësitrat.	Duhet të rinisë urgjentisht monitorimi i rrjedhës me qëllim përgatitjen e përlogaritjeve të burimeve ujore të kohëve të fundit. Zbatimi i Shërbimit për Paralajmërimin e Përmytjeve me qëllim lajmërimin e popullatave lidhur me situata të mundshme rreziku
Vjetërsia/mungesa e sistemeve të përshtatshme të monitorimit dhe parashikimit.	Përmirësimi i sistemeve të monitorimit dhe parashikimit, procedurat e lajmërimin dhe sistemet e paralajmërimin të hershëm për përmytjet. Ndryshimi ose revokimi i lejeve për marrje gjatë thatësirave.

8. Vazhdimësia dhe Morfologjia e Kanalit Lumor dhe Fushës Aluvionale

8.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme?

Ndërhyrja në ose shkatërrimi i habitateve ujore përmes ndryshimeve të kanalit lumor dhe fushes aluvionaleka një ndikim madhor shqetësues mbi llojet ujore dhe të ashtuquajturat “shërbime të ekosistemit”. Shërbimet e ekosistemit janë kontributet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të ekosistemeve për mirëqenien e njeriut.

Shembujt tipikë përfshijnë dëmet e drejtpërdrejta në ekosistemet ujore përmes nxjerrjes së papërshtatshme zhavorri, pengesa në shumimin dhe migrimin e peshqve dhe specieve të tjera pas ndërtimit të pengesave, digave dhe pendëve, kanalizimi i lumenjve si pasojë e urbanizimit dhe ndarja e fushave natyrale lymore nga korridori i lumit si rezultat i skemave të mbrojtjes nga përmytja. Të gjitha këto veprimtari ndikojnë drejtpërsëdrejti cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ekosistemeve toja ujore.

8.2 Problematikat Aktuale

Ka neglizhencë dhe injorancë të gjerë lidhur me efektet dëmtuese të morfologjisë së ndërprerë dhe vijimësisë të kanaleve lumore në Shqipëri. Lejohet zhvillimi i shumë skemave pa një vlerësim të plotë dhe të përshtatshëm të ndikimeve në mjedis. Pritat dhe digat ndërtohen pa mundësi për kalimin e peshqve apo vijimësi të habitateve.

Nxjerrja e zhavorrit

Në pjesën e poshtme të rrjedhës në bashkimin e lumenjve Fan dhe Mat nxirren sasi të mëdha zhavorri nga shtrati i lumit. Nxjerrja e zhavorrit ka ndikim të rëndësishëm në tiparet hidro-meteorologjike të shtratit të lumit, aq sa duhet të kategorizohen si lloje të modifikuara lumenjsh, të cilët nuk janë të aftë të ruajnë diversitetin biologjik natyror, duke parandaluar kështu statusin e mirë ekologjik.

Në basenin e Lumit Mat, veprojnë me licencë një sërë shoqërisht të nxjerrjes së zhavorrit. Kapaciteti i kombinuar i tyre prodhues është i barabartë me rreth 1 200 000 m³/vit zhavorr dhe rërë.

Efektet e supozuara të ndikimeve mjedisore që lidhen me nxjerrjen e zhavorrit po shtohen. Këto ndikime përfshijnë: humbjen ose degradimin e vendeve të shumimit dhe habitateve të rritjes së peshkut, bllokimin e migrimit, zgjerimin e kanaleve, cekëtimin ose krijimin e pellgjeve; humbjen e stabilitetit hidrogjik dhe të kanalit; humbjen e strukturave të thellimit dhe cekëtimin, rritjen e turbullirës dhe transportin e sedimentit; shtimin e erozionit të brigjeve dhe/ose erozionit vertikal të shtratit; dhe humbjen apo degradimin e habitateve të brigjeve lumore.

Nga ana tjetër, nxjerrja e zhavorrit është burim me rëndësi ekonomike duke qenë se është burimi kryesor për material në industrinë e ndërtimit. Gjatë vlerësimit të aplikimeve për nxjerrjen e zhavorrit, Zyra e Administrimit të Basenit Ujor / AMBU duhet të sigurohet që kjo nxjerrje po kryhet në mënyrë të qëndrueshme jo vetëm sa i përket burimeve të zhavorrit

(shkalla dhe volumet e nxjerrjes duhet të rregullohen nga afër), por edhe sa i përket ndikimeve mjedisore.

8.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Ekosistemet mirëmbajnë rrjedhën dhe furnizimin me ujë, rregullojnë cilësinë e ujit dhe pakësojnë katastrofat që lidhen me ujin. Ekosistemet ujore sigurojnë burime natyrore, si peshku, produkte të kullotave dhe pyjeve, mbështesin një gamë të gjerë procesesh prodhimi dhe konsumi, duke përbërë shpesh vlerë të madhe ekonomike, por kjo vlerë kuptohet pak dhe shprehet rrallë. Si pasojë, shpesh nuk merret parasysh gjatë vendim marrjes, duke rezultuar në mungesë fondesh dhe mungesë uji për ekosistemet. Rrjedhimisht, këto ekosisteme humbin vlerën e tyre ekonomike, sepse ato degradojnë ose shkatërrohen.¹⁷

Aktualisht AMBU apo Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) nuk kanë një inventar të veçantë për zonat me rëndësi ekologjike ujore.

Ka nevojë parësore që AMBU të punojë në këshillim me AKZM-në për të identifikuar dhe hartëzuar të gjithë trupat ujorë të veçantë që lidhen me zonat e mbrojtjes së veçantë (Direktiva 2009/147/KE), zonat e veçanta për konservim (ZVK) (Direktiva 92/43/KEE)¹⁸ dhe të identifikojnë trysnitë dhe statusin aktual ekologjik të këtyre trupave ujorë. Veçanërisht kjo përfshin mbrojtjen e ekosistemeve që varen nga ujërat nëntokësore, çka është një objektivi i veçantë mjedisor në kuadër të Direktivës Kuadër të Ujit.

Gjithashtu nevojitet të ndërmerret një procedurë VNM përpara lëshimit të lejeve për nxjerrjen e zhavorrit.

Një skenar i thjeshtë menaxhimit për veprimtaritë e nxjerrjes së zhavorrit, me qëllim pakësimin e ndikimeve të lëshimit të këtyre lejeve, duhet të bazohet në vlerësimet e ndikimit në mjedis, duke theksuar sa vijon:

- Sondazhet biologjike për përcaktimin e të dhënave mjedisore të bazës fillestare, dhe për përcaktimin e masave lehtësuese me qëllim shmangien ose pakësimin e ndikimeve negative në mjedis;
- Monitorimin e veprimtarive të lejuara dhe justifikimin e ndikimeve mjedisore në përputhje me lejen;
- Përcaktimin si pjesë e lejeve që kostot për rivendosjen dhe zbatimin e një programi afatgjatë monitorimi dhe rikthimi në gjendjen fillestare për zonat ku është aplikuar për leje për nxjerrje zhavorri, paguhen nga kontraktori.

¹⁷ Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (BNRN) - Konsiderimi i Ekosistemeve si Pjesë Ekonomike e Infrastrukturës së Ujit, 2004

¹⁸ https://ec.europa.eu/environment/nature/natura2000/sites/index_en.htm

8.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 8-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Vazhdimësia dhe Morfologjia e knalit lumor dhe fushës aluvionale	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Mungesa e hartave të botuara që tregojnë trupat ujorë me status të veçantë ekologjik (ZMV-të) (ZKV-të)	AMBU duhet të bashkërendohet me AKZM për të hartëzuar trupat ujorë të veçantë dhe identifikuar ato që lidhen me vlera të veçanta ekologjike. Për këto trupa ujorë janë të nevojshme kushtet e referencës.
Trupat Ujorë të Tejet të Modifikuar (TUTM) janë një lloj i veçantë trupash ujorë në Direktivën Kuadër të Ujit. Këto duhet të identifikohen.	AMBU duhet të identifikojë të gjitha TUTM-të dhe të propozojë masa për përmirësimin e potencialit ekologjik të tyre.
Nxjerrja e zhavorrit është problem madhor në pjesën e poshtme të basenit të Matit.	Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Tiranë (Mati) duhet të pajiset me instrumentet bazë për vlerësimin dhe identifikimin afatgjatë të risqeve mjedisore, apo vendim marrjen e mirë lidhur me menaxhimin e ujit (apo edhe të nxjerrjes së zhavorrit).

9. Prurjet Mjedisore

9.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme?

Një sasi e madhe provash ka treguar se regjimi i prurjeve për të gjithë lumenjtë (të vegjël dhe të mëdhenj) luan rol kryesor në strukturën dhe funksionimin e ekosistemeve ujore. Thuajse të gjithë ekosistemet që varen nga lumenjtë, liqenet, ligatinat dhe ujërat nëntokësore kontrollohet kryesisht nga regjimi hidrologjik.¹⁹ Ndryshimi i origjinës dhe sasisë së ujërave që rrjedhin në lumë gjatë një vitit të zakonshëm siguron habitatin dhe ndikon në mënyrë të konsiderueshme cilësinë e ujit, temperaturën, ciklin e ushqyesve, disponueshmërinë e oksigjenit, dhe proceset e ndryshimeve gjeologjike që formësojnë kanalet e lumenjve dhe fushat lymore.

Në kundërshtim me praktikën aktuale në Shqipëri dhe në disa vende të tjera të Evropës, ‘prurjet natyrore’ NUK JANË vetëm një vlerë minimale që duhet të ruhet në kanalën e lumit. Faktikisht, rrjedha natyrore përfshin gamën e plotë, kohën dhe variacionin e të GJITHA prurjeve natyrore përgjatë vitit.²⁰ Kur ky regjim natyror ndryshohet, për shembull përmes devijimit të rrjedhës për prodhim energjie, apo shkallës së tepruar të nxjerrjes për ujitje apo për qëllime vendore, regjimi i ndryshuar mund të ketë ndikime të rëndësishme dëmtoese në ekosistemin ujor, duke ulur, thuajse me siguri, statusin e trupi ujor në më pak se i “Mirë”, që është edhe objektivi kyç mjedisor i Direktivës Kuadër të Ujit.

9.2 Problematikat Aktuale

Aktualisht, prurjet natyrore nuk kuptohen qartë në Shqipëri dhe metodat aktuale për përlllogaritjen e tyre janë të vjetra dhe nuk përputhen me metodat sipas praktikës më të mirë ndërkombëtare. Është thuajse e sigurt që ‘rrjedha minimale ekologjike’ e parashikuar në Ligjin për Ujin²¹, bazuar në rrjedhën që arrihet ose kalohet gjatë një periudhë prej 355 ditësh në vit (Q97), është tërësisht e pamjaftueshme për mbrojtjen e ekosistemeve ujore, dhe është gjithsesi një koncept problematik.

Një numër i madh hidrocentralesh në të gjithë Shqipërinë vijnë të miratohen bazuar në këtë kriter, duke lejuar mundësisht nxjerrjen dhe devijimin e të gjitha prurjeve mbi këtë shifër minimale.

Prodhimi i energjisë përmes burimeve hidrike nuk është përdorim konsumues i ujit (pra uji i nxjerrë kthehet në burimin e vet). Balanca e përgjithshme e ujit nuk ndryshon, por uji i disponueshëm për përdorim në rrjedhën e poshtme rregullohet pjesërisht nga funksionimi i rezervuarëve.

¹⁹ Komisioni Evropian - Rrjedhat ekologjike në zbatimin e Direktivës Kuadër të Ujit, Dokumenti Udhëzues i CIS 31, Raporti Teknik 2015-086.

²⁰ Fondi Botëror i Jetës së Egër - Të mbajmë lumenjtë gjallë - një Dokument Paraprak i Rrjedhave Natyrore dhe Vlerësimit të Tyre, WWF 2009.

²¹ Qeveria e Shqipërisë - Ligji 111/2012 Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore, ndryshuar me Ligjin Nr. 6 datë 08.02.2018 – Neni 39 Përdorimi i Burimeve Ujore

Kështu, funksionimi i hidrocentraleve ndikon prurjen natyrore duke a) devijuar sasi në periodha kritike.

Sot Shqipëria është thujse tërësisht e varur nga energjia hidrike për prodhimin e energjisë elektrike; thujse 100% e energjisë elektrike të prodhuar në vend vjen nga burime hidrike.


Në basenin ujqor të Matit, ka dy hidrocentrale të mëdha, ai i Ulzës dhe ai i Shkopetit, si dhe një sërë hidrocentralesh të përmasave të vogla (shihni pjesën për hidrocentralet).

Hidrocentrali (HEC) i Ulzës është ndërtuar në vitin 1952. HEC-i i Shkopetit u vu në funksion në vitin 1963, së bashku me HEC-in e Ulzës në një sistem kaskade. Për këto HEC-e nuk është kryer një vlerësim kumulativ ndikimesh.

9.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Figura 9-1 ilustron konceptin e praktikës më të mirë të menaxhimit të rrjedhës natyrore, duke identifikuar prurjen natyrore minimale për çdo muaj të vitit. Zakonisht, me qëllim ruajtjen e statusit të Mirë Ekologjik të trupit ujqor, nuk ka gjasa që më shumë e p.sh., 40% e prurjeve të nxirren gjatë muajve të lagësht si marsi dhe prilli, dhe kjo vlerë mund të ulet deri në diku 10% gjatë muajve të thatë të verës si gushti dhe shtatori. Marrja e sasive përtej këtyre shifrave degradon statusin ekologjik të trupit ujqor më tej. Në kuadrin e Direktivës 2000/60/KE, AMBU ka detyrën të parandalojë përkeqësimin e statusit të të gjithë trupave ujqorë.

Figura 9-1 – Koncepti i Praktikave më të Mira për Rrjedhën Natyrore



Koncepti i prurjes natyrore dhe zbatimi i tij për marjet e lejuara në Shqipëri duhet të riformulohet dhe rivlerësohet bazuar në opinionet e ekspertëve dhe praktikën më të mirë

ndërkombëtare. Praktika më e mirë ndërkombëtare tregon se kur shkalla e marrjes tejkalon vlerën e 25-30% të vlerës së mesme të prurjeve, statusi i trupit ujqor ka gjasa të jetë më pak se “Mirë”. Rritja e shkallës së nxjerrjes në më shumë se 30% do të ulë më tej statusin ekologjik të trupi ujqor. Këto përkeqësime kundërshtojnë drejtpërsëdrejti objektivat mjedisore të Direktivës Kuadër të Ujit.

9.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 9-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Rrjedhat Natyrore	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Supozimet aktuale që rrjedha Q97 është një vlerë minimale e pranueshme për rrjedhën natyrore mund të mos jetë i saktë.	Përcaktimi i konceptit dhe standardit kombëtar të ndryshimit minimal dhe maksimal të regjimit të prurjeve duhet të rivlerësohen.
Shumë hidrocentrale mund të mbajnë ujë në basenet e tyre që arrijnë nivele jo të qëndrueshme lidhur me kufijtë e rrjedhës natyrore.	Procedura e standardeve teknike që zbatohet në shkallë kombëtare duhet të zhvillohet me qëllim përcaktimin e saktë të rrjedhës natyrore të qëndrueshme që përputhet me arritjen e Statusit të Mirë Ekologjik në Direktivën Kuadër të Ujit.
Krijimi dhe lëshimi i rrjedhave artificiale të ujit (hydropeaking) përmes turbinave në hidrocentral mund të shqetësojë habitatet që ndodhen në rrjedhën e poshtme të prurjeve dalëse.	Procedura e Standardeve Teknike që zbatohet në shkallë Kombëtare duhet të zhvillohet më tej, me qëllim identifikimin e shkallës së ndikimit të veprimtarive të hidrocentraleve të propozuara mbi statusin ekologjik të trupit ujor dhe ndikimin hidro-morfologjik.

10. Përdorimi i Ujit, Marrja e Ujit dhe Leja për marrje

10.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme?

Burimet ujore në basenin ujqor të Matit janë të fundme. Kjo do të thotë se bazuar në të mesmen afatgjatë të reshjeve vjetore, kemi një numër të fiksuar rimbushjesh për furnizimin e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore çdo vit. Si pasojë, uji është burimi vyer, të cilin duhet ta monitorojmë, menaxhojmë dhe shpërndajmë midis përdoruesve sipas metodave dhe procedurave të mirëpërcaktuara. Kjo vlen si për burimet e ujërave sipërfaqësore, ashtu edhe për ato nëntokësore. Ka gjithashtu mundësi, që si pasojë e ndryshimeve klimatike, sasia e rinovueshme e disponueshme për përdorim çdo vit të ulet, sidomos gjatë viteve të thata të verës kur burimet ujore janë të pakta.

Marrja e pakontrolluar dhe e tepruar ka ndikime të rëndësishme dëmtuese mbi burimet tona ujore dhe trupat ujqorë në përgjithësi, dhe këto nxjerrje duhet të rregullohen më nga afër në të ardhme, me qëllim arritjen e një ekuilibri të qëndrueshëm midis nevojave mjedisore dhe ekonomike.

Furnizimi i basenit ujqor të Matit nga magazinat e ujërave nëntokësore përfaqësojnë një trysni për burimet e ujërave nëntokësore në ultësirën bregdetare, të mbizotëruar nga depozita me sasi të madhe zhavorri dhe aluviale. Ka një koncept të gabuar se për shkak se zonat e ujërave nëntokësore janë shpesh të mëdha dhe të thella ato kanë ‘shumë ujë’ të disponueshëm. Faktikisht, megjithëse volumet e ujërave nëntokësore janë zakonisht të mëdha, parametri kritik për këtë volum është ai i rimbushjes. Zakonisht, vlera e rimbushjes së ujërave nëntokësore janë vetëm 15-25% të reshjeve të përgjithshme në shumë basene ujore dhe si pasojë, ‘uji i disponueshëm për përdorim’ faktikisht është goxha i pakët.

Marrja e ujërave nëntokësore në vlera më të mëdha se kjo sasi e rinovueshme pakëson në mënyrë të përhershme dhe të vazhdueshme nivelin statik të ujërave nëntokësore. Kjo sjell si pasojë shumë ndikime: Prurjet e ujërave sipërfaqësore në lumenj bien, kostot e pompimit të ujërave nëntokësore rriten, përqendrimi i ndotjes në ujërat nëntokësore rritet, në zonat bregdetare, kombinimi i rritjes së nivelit të detit dhe uljes së nivelit të ujërave nëntokësore mund të sjellë depërtimin e kripës në zonat e ujërave nëntokësore, duke ndikuar si burimet ujore bashkiake ashtu edhe ato për ujitje.

10.2 Problematikat Aktuale

AMBU ka përgjegjësi të vazhdueshme për vlerësimin teknik dhe lëshimin e lejeve të reja për nxjerrjen e ujit, por ka një trashëgimi historike marrjesh të shumta furnizimi bashkiak dhe bujqësor që aktualisht nuk janë të lejuara apo të rregulluara.

Së dyti, për shkak të dështimit të rrjetit të monitorimit hidro-meteorologjik që prej fundit të viteve 90-të, faktikisht AMBU nuk është në gjendje të ketë një vlerësim sasior të saktë të burimeve ujore aktuale në basenin ujqor. Në kuadër të një emergjence ndryshimesh klimatike të pranuar në mbarë botën²², kjo mungesë njohurish për burimet tona ujore është tërësisht e papranueshme dhe kërkon veprime korrigjuese të menjëhershme. Nuk mund të mbështetemi

²² Revista e Bioshkencës - Paralajmërimi i Shkencëtarëve Botërorë për Emergjencën Klimatike, 2019

në të dhëna të vjetra nga periudha e viteve 1960-1990 kur rrjetet hidro-meteorologjike funksiononin në mënyrë të pranueshme, sepse këto të dhëna janë tashmë të vjetruara dhe nuk pasqyrojnë kushtet aktuale.

Sipas procedurave aktuale (në Shqipëri si ujërat nëntokësore ashtu edhe ato sipërfaqësore mund të përdoren për procese industriale dhe teknologjike) shumë nga instalimet e lejuara nuk i raportojnë rregullisht AMBU-t volumet e ujit që merren drejtpërsëdrejti nga lumenjtë dhe përrenjtë dhe që përdoren në proceset e tyre industriale. Volumet e ujit të marra nga lumenjtë dhe përrenjtë (pra jo përmes rezervuarëve) dhe të përdorur për ujitje në bujqësi, gjithashtu nuk monitorohen dhe raportohen. Kjo do të thotë se nuk mund të kryhen rishikime dhe kontrole të vazhdueshme të balancës vjetore të ujit.

Mungesa e kontrollit nuk është e qëndrueshme nga pikëpamja ligjore.

Dihet mirë (dhe raportohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si pjesë e informacionit të dhënë nga Grupi i Ekspertëve) se zakonisht, në shumicën e sistemeve të ujësjellësve në nivel vendor, humbjet faktike (pra nga rrjedhjet) arrijnë deri në 60%, pra vetëm 40% e ujit të nxjerrë mbërrin tek konsumatori. Kjo sasi humbesh të panevojshme (që në të njëjtën kohë krijon trysni të rëndësishme dhe ndikime mbi burimet natyrore) është tërësisht e paqëndrueshme në periudhën afatgjatë.

10.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhen

Marrja e tepruar e ujit nga burimet sipërfaqësore/nëntokësore është tërësisht e paqëndrueshme në periudhën afatgjatë. AMBU, në cilësinë e autoritetit kompetent, ka siguruar që në terma vjetorë nevojat mjedisore + konsumi i përgjithshëm i ujit nga baseni ujor të mos kalojë masën e burimeve vjetore të rinovueshme. Kjo përlllogaritje duhet të bëhet veçmas për ujërat nëntokësore dhe sistemet e ujërave sipërfaqësore (ndërkohë që duhet pranuar se shpesh sistemet e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore janë të ndërlidhur ngushtë).

Megjithatë me qëllim përgatitjen dhe përditësimin e rregullt të balancës vjetore të ujit, AMBU do të kërkojë të marrë të dhëna shumë më të besueshme se sa ato që janë të disponueshme aktualisht. Autoriteti kompetent (aktualisht IGJEUM) duhet të sigurojë të dhëna hidro-meteorologjike me cilësi më të lartë, në mënyrë që të përcaktohet saktë sasia e rimbushjes për basenet ujore; së dyti, të gjithë operatorët që nxjerrin ujë duhet të kenë detyrimin të raportojnë sasi të nxjerra të paktën çdo stinë, pra 4 herë në vit.

Duke qenë se AMBU ka përgjegjësinë e përgjithshme të sigurojë që përcaktimet e ujit po përdoren në mënyrë efikase dhe të efektshme, është gjithashtu e nevojshme që po ky kuadër raportimi të identifikojë produktivitetin ekonomik të ujit që po përdoret, në mënyrë që të identifikohen dhe të përmirësohen rastet e përdorimit joefikas të ujit.

Figura 10-1 – Shembull i një Raporti të Thjeshtë Tremujor për Nxjerrjet nga Operatori

Të dhënat e operatorit	Sasia e Ujit të marrë	Sasia e ujit të rikthyer	Sasia e Ujit të Humbur në Veprimtari	Përqendrimi i ndotësve (BOD ose tjetër),	Njësitë e Prodhimit
Operatori i Tipit 1-Bashkiak	MCM	MCM	MCM	Mg/l BOD5	Popullsia
Operatori i Tipit 2-Industrial	MCM	MCM	MCM	Mg/l PO4	Njësitë e prodhimit
Operatori i Tipit 3-Hidrik	MCM	MCM	MCM	-	Megavat Orë
Operatori i Tipit 1-Bujqësor	MCM	MCM	MCM	Mg/l NO3	Hektarë

10.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 10-1 – Veprimet e Mundshme për Programin e Masave

Përdorimi i Ujit, Nxjerrja e Ujit dhe Leja për Nxjerrje	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Balanca vjetore e ujit në basenin ujor nuk dihet aktualisht, sepse të dhënat e prurjeve dalëse janë të disponueshme vetëm për periudhën 1960-1992.	Statusi aktual i balancës vjetore të ujit duhet të ripërlllogaritet duket përdorur të dhëna të besueshme të kohëve të fundit. Duhet të hartohet procedura Kombëtare e Standardizuar Teknike për përcaktimin dhe publikimin e balancës së ujit.
Operatorët nuk i raportojnë rregullisht AMBU-st sasi të marra ose shkallën e prodhimit, kështu që strategjitë e shpërndarjes efikase të ujit nuk mund të hartohen.	Duhet të ngrihet një sistem standard ligjor shtrëngues për raportim tremujor të nxjerrjeve të ujit, dhe të gjitha të dhënat të ruhen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.
Regjistri i marrjeve (kërkesë e Direktivës Kuadër të Ujit, Neni 11) ekziston aktualisht, por është më së shumti i paplotë. Përdorimet industriale dhe bujqësore të ujit nuk paraqiten fare.	Regjistri Zyrtar i marrjeve të ujit duhet të përditësohet tërësisht, të standardizohet, dhe të gjithë operatorët duhet të detyrohen të regjistrojnë dhe të raportojnë shkallën e tyre të marrjes. Kërkohe bashkëpunim dhe bashkërendim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
Në basenin ujor kryhen një sërë marrjesh të jashtëligjshme dhe të paregjistruara, veçanërisht për ujitje në bujqësi. Si pasojë, nuk dihet niveli i përgjithshëm i nxjerrjeve nga burimet sipërfaqësore dhe nëntokësore.	Duhet të ketë një zbatim të gjithanshëm për regjistrimin e të gjitha marrjeve të jashtëligjshme dhe të palejuara. Nëse kjo praktikë vijon, nevojiten veprime urgjente për vlerësimin e situatës dhe për t'u siguruar që po arrihet një ekuilibër i përshtatshëm ndërmjet të gjitha nevojave në këtë fushë, duke zbatuar mundësisht tarifa për ujitje për ujitje, që të sigurojë që të gjitha palët të paguajnë

	<p>koston e plotë ekonomike, apo të krijojë shtysa negative për të shkurajuar përdorimin e dëmshëm të ujit.</p>
<p>Marrja e jashtëligjshme / e pakontrolluar.</p>	<p>Parandalimi i marrjeve pa leje ose të paautorizuara ndihmon me menaxhimin e burimeve ujore në klimën aktuale dhe atë të ardhshme.</p> <p>Marrja e ujit është e ndaluar pa leje apo autorizim.</p>
<p>Menaxhimi i papërshtatshëm i marrjeve, në kuadrin e qëndrueshmërisë, efektshmërisë dhe zbatimit të kufijve mjedisorë.</p>	<p>Menaxhimi i marrjeve përmirëson aftësinë tonë për menaxhimin e burimeve ujore në klimën aktuale dhe atë të ardhshme.</p> <p>Përshtatje fleksibël një sistem fleksibël licencimi do të thotë që nxjerrjet mund të modifikohen sipas nevojës dhe sipas ndryshimeve klimatike përmes rishikimit të licencave.</p> <p>Licencat e kushtëzuara për nxjerrjen e ujit dhe licencat e kushtëzuara</p> <p>Licenca për marrje të kufizuara në kohë.</p>
<p>Mungesë kontrolli në kohë thatësire.</p>	<p>Kontrollet më strikte na ndihmojnë të menaxhojmë thatësitat në klimën e tashme dhe atë të ardhshme. Mund të nevojitet të theksohet risku në rritje nga thatësitat në kuadrin e ndryshimeve klimatike (dhe të probabilitetit më të madh për thatësira natyrore krahasuar me sa planifikohen aktualisht nga palët përgjegjëse) dhe të përgatiten nxjerrësit lidhur me të.</p> <p>Ndryshimi ose revokimi i lejeve për marrje uji gjatë thatësirave.</p>
<p>Detyrat e mbrojtjes menaxhimit dhe cilësisë dhe mjaftueshmërisë së furnizimeve dhe promovimit të efikasitetit të ujit.</p>	<p>Shoqëritë UK duhet të marrin në konsideratë ndikimin e ndryshimeve klimatike në ekuilibrin kërkesë-ofertë, të përlogarisin gjurmën e tyre të karbonit dhe të përdorin kosto alternative të karbonit për krahasimin e alternativave të tyre.</p>

11. Shkarkimet e Ujërave të Ndotura, Ndotja e Ujërave dhe Leja për Shkarkim

11.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme

Shkarkimet e ujërave të ndotura janë ato prurje që kthehen kryesisht në lumenj ose në ujërat bregdetare pas nxjerrjes dhe përdorimit të tyre për qëllime të veprimtarive bashkiake, industriale apo hidrike. Në rast të përdorimit të ujërave për qëllime të veprimtarisë bashkiake dhe industriale, pa kryer më parë trajtimin e duhur të tyre, në trupat ujorë sipërfaqësorë shkarkohen sasi të konsiderueshme ndotësish, duke ndikuar kështu në mënyrë të konsiderueshme mjedisin, gjallesat ujore dhe duke përkeqësuar statusin ekologjik të trupave ujorë.

Ndotja e ujërave natyrorë nga ujërat e ndotura urbane të patrajtuara më parë është një prej problematikave më të mprehta në Shqipëri. Masa e ndotësve që vjen si pasojë e mbetjeve urbane mund të përcaktohet duke u mbështetur në vlerat njësi për 1 person²³:

- Kërkesa për oksigjen biokimik (BOD₅) = 60g/person/ditë.
- Totali i Nitrogjenit (TN) = 11 g/person/ditë.
- Totali i Fosforit (TF) = 2,8 g/person/ditë.

Krahas objektivave ambicioze të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2011-2017, mbulimi me kanalizime është përmirësuar vetëm në zonat urbane, ndërsa në zonat rurale të vendit lë për të dëshiruar. Disa zona në vend po hasin problematika të mëdha lidhur me cilësinë e ujit. Për më tepër, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura mbeten ende në nivele të ulëta dhe kanë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm.

Shifrat kombëtare për mbulimin me kanalizime tregojnë dallime të mëdha të normës së mbulimit për zonat urbane dhe rurale (përkatesisht 76% kundrejt 13% për kanalizimet). Në përgjithësi, shërbimet e menaxhimit të ujërave të ndotura janë mjaft të papërshtatshme. Mbulimi me kanalizime i zonave urbane në vitin 2017 ishte 50.2% (75.4% për zonat urbane dhe 12.2% për zonat rurale) dhe janë ndërtuar vetëm 9 Impiante për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN), prej të cilave vetëm shtatë janë funksionale, duke i shërbyer kështu rreth 13% të popullsisë. Katër ITUN-e janë ose në ndërtim e sipër, ose në proces rehabilitimi/zgjerimi.

Shërbimi i Ujësllës-Kanalizimeve mbetet përgjithësisht i ulët për shkak të mirëmbajtjes së pamjaftueshme të infrastrukturës dhe sistemeve, praktikave të dobëta operationale dhe të menaxhimit, si dhe aspekteve të dobëta të qeverisjes (që nga ana tjetër prekin realizueshmërinë financiare të shumicës së ndërmarrjeve të ujësllës-kanalizimeve në vend). Në nivel ndërmarrjeje, kapaciteti për sa i përket aftësive teknike dhe personelit të kualifikuar, veçanërisht në nivelin e drejtimit, operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të aktiveve është i ulët. Lëvizshmëria e lartë e stafit e përkeqëson edhe më tej problemin.

²³ PE: Për 1 person. Vlerat e përdorura gjerësisht në vendet e BE-së.

11.2 Problematikat aktuale

Baseni Ujor i Matit ndotet kryesisht nga *familjet*, të cilat arrijnë në 234.000 banorë gjithsej. Densiteti i popullsisë është më i madh në pjesën qendrore dhe në ultësirën bregdetare të basenit.

Aktualisht, në basenin ujqor të Matit nuk ka impiante për trajtimin e ujërave të ndotura. Supozohet se të gjitha mbetjet e lëngëta shkarkohen drejtpërdrejtë në mjedis, por nuk ka të dhëna për trysnitë specifike të shkarkimeve të ujërave të ndotur te cilësia e ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe të dheut.

Megjithatë, sasia e TF-së, TN-së dhe BOD⁵ dhe konsumit të ujqit në basen mund të llogariten sipas tabelës 11.1.

Duke supozuar se prurjet mesatare janë 3,250 mil. M³/vit³/vit në lumin e Matit, ndikimi i përqendrimeve të TN-së, TF-së dhe BOD⁵ mund të llogaritet sipas tabelës 11.2.

Megjithatë, këto supozime janë me shumë gjasa më të larta nga ç'paraqiten realisht, pasi pjesa më e madhe e TN-së, TF-së dhe BOD⁵ nga familjet ose kalon në tokë, ose transformohet gjatë transportimit në lum. Krahas kësaj, prurjet e lumit prej 3,250 mil. M³/vit³/vit mund të monitorohen vetëm në rrjedhën e poshtëm të lumit të Matit. Por, në versionet e mëvonshme të planit, këto përlllogaritje do të kërkohen edhe për nënbasenet për të vlerësuar se si të arrijmë ose të ruajmë statusin e mirë kimik të ujqit nëpërmjet një programi masash.

Tabela 11.1: Sasia ditore dhe vjetore e ndotësve për 1 person dhe për 234.000 banorët e basenit

1 person	Ditë	Vit	234,000 1 person/vit
TF	2.8 g	1.0 kg	234 t
TN	13.7 g	4.4 kg	1029 t
BOD ⁵	60 g	21.9 kg	5124 t
Konsumi i ujqit	273 l	50 m ³	11,7 mil. m ³

Tabela 11.2: Llogaritja e kontributit në përqendrim

Llogaritja konceptuale e kontributit në përqendrimet mesatare në lumin e Matit	
TF	0.072 mg/l
TN	0.317 mg/l
BOD ⁵	1.577 mg/l
Konsumi i ujqit	0,4% e prurjeve vjetore të rrjedhës së poshtme

Shifrat aktuale të vëna në dispozicion nga AKM-ja tregojnë se disa pjesë të basenit ujqor nuk e përmbushin pragun shqiptar të "Statusit të mirë" lidhur me parametrat fiziko-kimikë, kryesisht në pjesët e poshtme të lumit.

Të dhënat aktuale të monitorimit të cilësisë (përfshi "statusin ekologjik" sipas DKU-së) të burimeve ujqore në basenin ujqor të Matit janë të pamjaftueshme. Monitorimi i elementëve biologjikë të cilësisë nuk është kthyer ende në rutinë, ndërsa ngritja e skemave të klasifikimit kërkon shumë të dhëna të nxjerra në terren. Monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së burimeve ujqore kërkohet jo vetëm për përgatitjen e PMBU-së, por edhe për gjurmimin e rezultateve të zbatimit të programeve të masave.

Në basen, veprimtaritë industriale janë të pakta. Pjesa më e madhe e rreziqeve të ndotjes nga veprimtaritë industriale vijnë nga sektori i minierave, ku ujërat e ndotura vetëm sa trajtohen paraprakisht në basene të vogla sedimentare dhe më pas shkarkohen normalisht mbi depozitat e materialeve inerte, që kontribuon në formimin e llokajës.

Trysnitë nga bujqësia, hortikultura dhe blegtoaria brenda basenit ujor lidhen me ndotjen organike dhe joorganike kryesisht nga BOD-ja, azoti dhe fosfori, të cilët mund të shkaktojnë deoksigenimin dhe eutrofikimin e ujërave sipërfaqësore dhe kontribuojnë në zvogëlimin e fondit të peshqve, humbjen e biodiversitetit dhe ndotjen e burimeve nëntokësore dhe parandalimin e përdorimit të ujit për qëllime argëtuese.

11.3 Pasojat dhe nevojat në të ardhmen

Legjislacioni i Bashkimi Evropian parashikon masat kundër ndotjes kimike të ujëra sipërfaqësorë kryesisht përmes Direktivës për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC), e cila autorizon mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura në aglomeratet urbane me një popullsi të barasvlershme me 2,000 dhe trajtim më të avancuar në aglomerate me popullsi të barasvlershme me 10,000 në zonat e ndjeshme. Qëllimi i Direktivës është të sigurojë mbrojtjen e mjedisit ujor përmes dy standardeve kyçe: i) ujërave të ndotura me përqendrim BOD-je jo më të lartë se 25 mg/l dhe ii) mbetje të ngurta jo më tepër se mg/l për aglomerate > 10,000 për 1 person, ose 60 mg/l për aglomerate prej 2,000-10,000 për 1 person.

Nëse Shqipëria dëshiron ta zbatojë direktivën në të ardhmen, për basenin ujor Mat, duhen marrë parasysh sa më poshtë vijon:

- Identifikimi i aglomerateve urbane që përfaqësojnë më tepër se 2000 PE, ku mund të ngrihen sistemet e mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të ndotura.
- Identifikimi i “zonave të ndjeshme”, si baza për ngritjen e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura me teknologji të trajtimit parësor dhe tretësor.
- Hartimi i plani për trajtimin e ujërave të ndotura për ngritjen e impianteve të trajtimit për aglomerate mbi 2000 PE ose magazina ushqimore me ngarkesë që përfaqësojnë mbi 4000 PE.
- Caktimi i një kalendari dhe kapaciteti financiar në 3 hapa. Hapat e parë për impiantet me mbi 100,000 PE. Në hapin e dytë për impiantet 10,000-100,000 PE dhe hapave të tretë për impiantet 2,000 – 10,000 PE.

11.4 Masat që mund të zbatohen në kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 11-1 – Veprime të Mundshme për Programin e Masave

Shkarkimet e Ujërave të Ndotura, Ndotja e Ujërave dhe Leja për Shkarkim	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës

<p>Sistemet e kanalizimit në zonat urbane që i shkarkojnë ujërat e ndotura pa i trajtuar më parë dhe klasifikimi i trupave ujore si në “status të keq”.</p>	<p>Kërkohen investime madhore në infrastrukturë dhe planifikim afatgjatë. Nuk ka gjasa të zgjidhet brenda kohëzgjatjes së kësaj PMBU-je</p>
<p>Grumbullimi i mbetjeve të ngurta krijon trysni ndotjeje</p>	<p>Promovimi i fushatave me bashkitë vendore për të çrënjësor kulturën e perceptimit të lumenjve si kanale për largimin e mbetjeve. Zbatimi i ligjit dhe procesimi i autorëve të veprave që demtojnë mjedisin.</p>
<p>Operatorë të shumtë që i shkarkojnë ujërat e ndotur pa Leje. Trajtimi në vend i mbetjeve të lëngëta industriale mungon në shumë vende.</p>	<p>Duhet përforcuar Regjistri i Shkarkimit të Ujërave të Ndotur. Të gjitha mbetjet e lëngëta industriale duhen identifikuar dhe regjistruar në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore. Zbatimi i detyruar i trajtimit në vend.</p>
<p>Sistemet aktuale të dhënies së lejeve për shkarkim nuk mbështetet te zbatimi i qasjes së kombinuar. Prandaj, efektet e kombinuara të shkarkimeve të shumta nuk llogariten.</p>	<p>Lejet për Shkarkime duhet të përdorin metoda më të sofistikuar të analizës, duke marrë në konsideratë statusin e ujërave pritëse dhe shkarkimeve aktuale.</p>

12. Digat dhe Hidrocentralet

12.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme

Përdorimi i energjisë hidrike ka pësuar rritje të qëndrueshme gjatë viteve të fundit në Shqipëri, duke e furnizuar kështu vendin me energji të pastër dhe të rinovueshme, por edhe duke modifikuar ekosistemet ujore.

Energjia hidrike mund të prodhojë energji elektrike pa çliruar gaze serrë. Megjithatë, mund të shoqërohet edhe me kërcënime mjedisore dhe sociale, si p.sh dëmtimi i habitatit të botës së egër, dëmtimi i cilësisë së ujit për shkak të ndryshimit të temperaturës së ujit dhe rrjedhës së lumit, pengimit të migrimit të peshqve dhe uljes së vlerave të lumenjve për qëllime argëtimi.

Tendenca më e fundit hidroelektrike lidhur me ndërtimin e HEC-eve të vogla që mund të prodhojnë energji elektrike për një komunitet të vetëm po kthehet tashmë në problematikë mjaft të mprehtë mjedisore për sa i përket statusit të shumë trupave ujorë të prekur në Shqipëri, të cilët duhen vlerësuar me kujdes.

12.2 Problematikat aktuale

Në basenin ujqor të Matit, ndodhen dy hidrocentrale të mëdha: Ulza dhe Shkopeti (tabela 12.1) si dhe një sërë HEC-esh të vogla dhe të mesme (tabela 12.2)

HEC-i i Ulzës ndodhet në afërsi të qytetit të Lezhës. HEC-i u ndërtua në vitin 1952 dhe është aktualisht hidrocentrali më i vjetër në gjendje pune.

HEC-i i Shkopetit ndodhet afro 25 km mbi grykën e lumit. Ai u vu në përdorim në vitin 1963, së bashku me HEC-in e Ulzës në sistemin e kaskadës.

Rezervuari i Ulzës ka një sipërfaqe prej 12.5 km², me një thellësi maksimale prej afro 61 m dhe ndodhet 129 m mbi nivelin e detit. Bazuar në informacionet ekzistuese mbi kapacitetin prodhues të hidrocentralit, kapaciteti mbajtës i rezervuarit të Ulzës është i barabartë me afro 15% të burimeve të disponueshme në ultësirën bregdetare poshtë Milotit. Nuk ka gjasë që kapaciteti prodhues i HEC-it të ushtrojë trysni mbi burimet e disponueshme në asnjë periudhë të vitit, pasi kapaciteti maksimal arrihet gjatë dimrit dhe pranverës, kur vërshimet janë maksimale.

Të dhënat mbi HEC-et paraqiten në Tabelat 12.1 dhe 12.2.

Tabela 12.1: HEC-et në Basenin Ujqor të Matit

Emri	Kapaciteti i instaluar (MW)	Prodhimi vjetor (GWh)	Vëllimi mbajtës (Mm ³)	Viti i vënies në punë
Ulza	25	120	240	1957
Shkopeti	24	90	15	1965

Tabela 12.2. Hidrocentralet e përmasave të vogla e të mesme në Basenin e Maitit

HEC	Data e skadimit te lejes	Lumi, Perroi i perdorur	Lumi	Koordinatat e vendmarrjes		KUOTA E VEPRES SE MARRJES (Z) (m.m.n.d)	Koordinatat e HEC		Prurja mesatare m³/s	Mesatarja e llogaritur m³/s	Prurja ekologjike m³/s
				x	Y		x	Y			
HEC "Antena"	27/4/2022	Zalli i Shtames	Mat	4408449,13	4699596,65	931,03	4409540,97	4599687,17	0,051	0,0872	0,0064
				4408449,13	4599596,65	933,77			0,051	0,0872	0,0064
				4408798,69	4598421,73	936			0,03	0,0511	0,0038
				4408909,59	4600210,68	953,56			0,107	0,184	0,0136
				4408909,59	4698241,6	935			0,1	0,171	0,0127
HEC " Fushe-Arrez"	27/4/2022	Fan I Madh	Mat	4420779,92	4660637,33	549,3	4418054,63	4658628,01	2,64	4,42	0,221
HEC "NDERFUSHAS"	27/4/2022	Sharres	Mat	4437738,19	4584319,47	1056,6	4437183,15	4585378,45	0,17	0,95	0,0175
HEC "EME"	27/4/2022	Gurzit	Fan i Vogel	4430391	4644224,2	516	4429796,5	4644472,7	0,924	1,6	0,106
HEC" GURRA"	27/4/2022	Gurra e Madhe	Mat	4403496	4616916	269	4403753	4617172	0,058	0,158	0,003
				4403594	4616690	275			0,092	0,242	0,004
HEC "Trajen 1"	22/9/2022	Trajes	Mat	4408280	4609380	370	4409940	4611960	0,71	0,9	0,022
HEC" Madhesh	22/9/2022	Lumrese	Mat	4406073	4610945	193,87	4404946	4613334	0,752	0,99	0,023
				4405572	4611053	200			0,084	0,11	0,003
HEC " Mëshurdh	27/4/2022	Mershurdhit	Fan	4416109	4650506	650	4417015,228	4650980,166	0,0195	0,3	0,02
				4415149	4651813	628			0,35	0,06	0,003
				4416026	4650346	630			0,08	0,14	0,008
HEC " LETAJ"	27/4/2022	Thekres	Mat	4438279,26	4587301,2	1102	4437152,84	4587459,7	0,039	0,08	0,0041
				4438115,94	4587896,62	1107			0,033	0,069	0,004
				4438223,72	4587755,41	1104			0,183	0,379	0,2
HEC "Deni"	27/4/2022	Perpizes	Mat	4431992,98	4591577,45	991,5	4431136,5	4590858,69	0,19	0,348	0,02
HEC "Thirrë"	27/4/2022	Kumbulles	Fan i Vogel	4437388,5	4652688	883	4434904,3	4651572,9	0,33	0,6	0,028
				4436429,8	4653217,4	878			0,17	0,32	0,015
				4435224,8	4654192,5	893			0,15	0,28	0,013
HEC " Dardhaz"	26.7.2023	Dardhaz	Fan i Vogel	4435894	4649173	716			0,411	1,637	
				4435329	4648085	716			0,545	1,637	
HEC " PAMBAD"	27/4/2022	Zalli i Hotit	Mat	4409818,4	4612542	212,5	4409468,3	4614873,5	0,845	1,816	0,21
HEC "Merkurthi 2"	27/4/2022	Mermkurthit	Mat	4428581	4631263	976,2	4427065,17	4630344,13	0,502	0,97	0,0245
HEC "Osmani"	22/9/2022	Perpizes	Mat	4431175	4590853	676	4429200	4588035	0,17	0,2	0,03
				4431353	4590297	676			1,7	1,24	0,2
HEC " SHINI"	27/4/2022	Bizes	Mat	4430200	4579150	1220	4431600	4586200	0,34	0,42	0,029
HEC "Shellli"	27/4/2022	Gryka e ShëlliutM	Mat	4427047,34	4613613,84	853	4423976,43	4614370,58	0,188	0,4	0,023
HEC "Guri I Zi"	27/4/2022	Kurvajes	Mat	4424290	4611923	361	4422045,43	4613475,04	0,205	0,4	0,019
				4424164,25	4613566,98	358,83			0,347	0,6	0,033
				4423624,13	4614350,56	356			0,411	0,8	0,039
HEC "Daznjane	27/4/2022	Daznjane	Mat	4425826,47	4616201,26	890,6	4423976,43	4614370,58	0,232	0,4	0,029

HEC "Kryezi"	27/4/2022	Perroi Kryeziut	Fan I Madh	4423148,88	4661783,03	620	4420833,69	4660721,06	0,849	1,086	0,064
				4421524	4662474,56	613			1,79	3	0,134
HEC "FIORINA"	22/9/2022	Fan I vogel	Mat	4426574	4637876	380	4425465	4637336	7,48	8,2	0,605
HEC Mallunxa	25.7.2023	P/Zallit te Madh	P/Luses	4424650	4609554	340	4422707	4607307	2,04	2,6	0,23
HEC Doma	25.7.2023	P/Luses	P/Luses	4426602	4603377	494,5	4422745	4607346	0,7	0,9	0,09
HEC KALIVARE 1	30.5.2023	P/Kimzes	Fan i madh	4423305	4649964	930	4418590	4648866	0,028	0,04	0,002
				4423331	4649768	925,9			0,028	0,04	0,002
				4423327	4649515	925			0,116	0,2	0,009
				4423002	4649282	935			0,028	0,04	0,002
HEC KALIVARE 2	30.5.2023	P/Kimzes	Fan i madh	4421657	4650190	566,32	4418590	4648866	0,104	0,15	0,008
				4421691	4649647	566,9			0,03	0,05	0,002
				4421421	4649083	652,68			0,046	0,1	0,003
HECKALIVARE 3	30.5.2023	P/Mesulit	Fan I madh	4422765	4646916	922,25	4418590	4648866	0,25	0,52	0,019
				4422858	4646816	921,23			0,034	0,06	0,003
				4422697	4646445	922			0,121	0,06	0,009
				4422491	4646025	922			0,055	0,06	0,004
HEC KALIVARE 4	30.5.2023	P/Mesulit	Fan I madh	4420284	4647546	454,6	4418590	4648866	0,19	0,3	
HEC Arrez	30.5.2023	P/Zi	L/Fan	4409362	4644676	1050	4409607	4640409	0,079	0,1	0,007
				4409685	4644121	1047,78			0,035	0,06	0,03
				4410076	4643987	1049,2			0,035	0,06	0,03
				4410951	4642514	1048,63			0,075	0,15	0,007
				4411142	4642358	1048			0,065	0,06	0,006
HEC Kacinar	30.5.2023	P/Zi	L/Fan	4407350	4642067	556,8	4410050	4636889	0,46	0,8	0,041
		P/Majushit		4408746	4640352	556,1			0,26	0,15	0,023
		P/Arrzes		4409656	4640465	556,3			0,48	0,46	0,043
HEC Simon	30.5.2023	P/Shperdhazes	L/Fan	4409964	4636988	300	4408310	4633895	1,45	2,11	0,13
P/Beqirajve		4410164		4637030	300	0,29			0,5	0,026	
HECSimon		P/Shperdhazes		4408315	4634103	212			4407382	4632295	2,44
HEC Blaç Vep marr kryesore, kaptazh 1,2,3	30.5.2023	P/Kumbulles	L/Urake	4431116	4629358	1650	4429661	4630179	0,78	0,11	0,02
				4431653	4629993	1658,92			0,03	0,05	0,001
				4431476	4629900	1656,7			0,032	0,05	0,001
				4430499	4627956	1710			0,075	0,12	0,001
HEC/SHENGJUN	18.01.2024	P/Bejnit	L/Mat	511035,536	4594861,29	373,55	507622,223	4595897,734	1,53	2,2	0,207
HEC/Darsi 1	24.01.2024	P/Darsit	L/Mat	414665,983	4593745,04	876	419387,994	4592388,764	0,61	1,693	0,09
HEC/Darsi 2	24.01.2024	P/Darsit	L/Mat	419472,698	4592362,9	632	421419,233	4594957,483	2,11	4,135	0,35
HECSHUTRI 1	25.7.2023	P/Shutrise	P/Shutrise	501621,9	4619911	480	500721,7	4618000	0,127	0,14	0,013
HEC SHUTRI 2	25.7.2023	P/Shutrise	P/Shutrise	500890,4	4618032,8	154	499715,7	4617617	1,82	9,5	1,09
HEC Vinjulli 1	25.7.2023	P/Varroshit,	P/Luses	4430445	4610868	660	4428470	4609906	0,6	0,77	0,076
		P/Manazdres		4430499	4609599	662			0,2	0,26	0,024
		P/Lajthit		4430120	4608900	672			0,13	0,17	0,015
HEC SANG	25.7.2023	P/Thirres	L/Fan	4434850	4651470	675	4433205	4649553	1,14	1,9	0,078
		P/Hebjes		4432336	4650777	675			0,38	0,7	0,026

HEC DARDHAZ Vep marr 1, 2, 3	25.7.2023	P/Dardhez	L/Fan	4435894	4649173	716	4433223	4648434	0,54	0,95	0,039
		P/Melthit		4435329	4648085	716			0,41	0,8	0,029
		P/Plepit		4434220	4648145	712			0,1	0,15	0,007
HECZall xhuxhe 1 vep marr 1,2	25.7.2023	P/Zall Xhuxhe	L/Fan	4646087,209	4427082,74	943	4645177,183	4427703,863	0,33	0,8	0,011
				4645084,605	4426599,22	764			0,44	0,8	0,014
HEC Zall xhuxhe 2	25.7.2023	P/Zall Xhuxhe	L/Fan	4645143,463	4427730,57	588,8	4644811,912	4430105,002	0,77	1,6	0,024

Kapaciteti i instaluar i të dy impianteve së bashku është rreth 3% i kapacitetit të përgjithshëm të instaluar në Shqipëri, dhe prodhimi është rreth 3.5% i prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike në vend. Aktualisht, në Basen janë aktivë një sërë hidrocentralesh (42) me përmasa të vogla/mesatare. Është konstatuar se efektet pozitive dhe negative të projekteve të tilla nuk janë shqyrtuar në mënyrën e duhur gjatë procesit të licensimit për hidrocentralet.

12.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Përmirësimi i planifikimit strategjik dhe praktikave zbutëse përbën një nevojë urgjente për të pakësuar ndikimin e digave në mjedisin përreth duke zhvilluar metoda konsistente në nivel kombëtar dhe ekologjikisht të qëndrueshme për vlerësimin dhe rregullimin e të gjitha funksioneve të hidrocentraleve.

Metodologjia e mbrojtjes së prurjes natyrore minimale paraqet mangësi teknike, dhe përgjithësisht asnjë HEC nuk funksionon në bazë të një plani zyrtar të menaxhimit të rrjedhës natyrore.

Aktualisht, ndikimi i shumicës së HEC-eve në regjimin e rrjedhës së poshtme dhe statusin ekologjik të trupave ujorë nuk vlerësohet në mënyrë të saktë.

12.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 12-12-1 – Veprime të mundshme për Programin e Masave

Digat dhe Hidrocentralet	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Në Basenin e Matit po zhvillohen një sërë projektesh për hidrocentrale. Sipas kadastrës së AMBU-së, aktualisht janë aktive 42 leje. Gjithashtu, edhe komuniteti vendas dhe grupet për mbrojtjen e mjedisit janë kundër zhvillimit të këtyre projekteve.	Aktualisht, ndikimi mjedisor i HEC-eve nuk vlerësohet në nivelin e duhur për të siguruar pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin mjedisor përkatës të Bashkimit Evropian. Krahas kësaj, ndikimi kumulativ i investimeve për hidrocentrale në peizazh, burimet ujore, faunën dhe florën duhet të konsiderohen si pjesë e procedurave ekzistuese.
Nuk ka në dispozicion asnjë Regjistër të përditësuar për marrjet e Ujit për prodhimin e energjisë elektrike.	Regjistri për marrjet e Ujit është kërkesë ligjore sipas Nenit 11 të DKU-së. Regjistri duhet të rikonceptohet për të përfshirë cilësitë e nevojshme që mundësojnë vlerësimin e saktë të ndikimeve mjedisore dhe atyre në rrjedhën ujore nga HEC-et.
Nuk ekziston një procedurë kombëtare e cila identifikon në mënyrë transparente ndikimet	Duhet të zhvillohet Procedura Kombëtare Teknike Standarde në përputhje me praktikën më të mira të BE-së dhe ato ndërkombëtare. Ndryshimi i mundshëm në

konkrete hidromorfologjike të çdo HEC-i dhe ndryshimet që shkaktohen në statusin e trupave ujqorë.	gjendjen dhe ndikimet mjedisore duhet të bëhet publik në mënyrë transparente.
Aktualisht nuk ekziston asnjë metodë teknike për vlerësimin e ndikimeve kumulative të funksionimit të njëkohshëm të disa HEC-eve në të njëjtin lum.	Duhet të zhvillohen instrumente të vlerësimin për të bërë të mundur vlerësimin e aplikimeve për Leje në kontekstin HEC-eve të shumëfishta që janë tashmë të autorizuara.

13. Shfrytëzimi, Mbrojtja dhe Monitorimi i Ujqerave Nëntokësore

13.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme

Gjatë dekadave të fundit, shfrytëzimi i ujqerave nëntokësore lidhej kryesisht me përdorimin e tyre si burime të ujit të pijshëm. Rreth 75% e banorëve të BE-së mbështeten në ujqerat nëntokësore për furnizimin me ujë. Megjithatë, politika e BE-së thekson se ujqerat nëntokësore nuk duhet të konsiderohen thjesht si burime të ujit të pijshëm, por duhet të mbrohen për vlerat e tyre mjedisore.

Ujqerat nëntokësore përfaqësojnë një pikë të rëndësishme të ciklit hidrologjik nëpërmjet mirëmbajtjes së ligatinave dhe rrjedhave lumore, duke vepruar si një zbutës i periudhave të thatësirës. Ujqerat nëntokësore si rrjedha bazë janë një komponent kyç i rrjedhës së lumenjve, shumica prej të cilëve përdoren për furnizim me ujë dhe veprimtari argëtuese. Prandaj, përkeqësimi i sasisë ose cilësisë së shkarkimit të ujqerave nëntokësore mund të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ekosistemet ujore dhe tokësore përkatëse.

Për shkak të natyrës së fshehur të ujqerave nëntokësore, menaxhimi i duhur i sasive të qëndrueshme ose i ndikimeve të ndotjeve është i vështirë, duke rezultuar në mungesë të dijensisë dhe/ose evidencave lidhur me nivelin e risqeve dhe trysnive.

Politikat e BE-së dhe menaxhimi në nivelin e lartë lidhur me ujqerat nëntokësore përcaktohen nga Direktiva Kuadër e Ujit (DKU) 2000/60/EC, Direktiva mbi Ujqerat Nëntokësore (DUN) 2006/118/EC dhe Direktiva mbi Nitratet (DN) 91/676/EEC. Në shumë prej lumenjve të Shqipërisë, zakonisht rreth 30-40% e prurjeve vjetore vijnë nga ujqerat nëntokësore. Në periudhat e verës me prurje të pakta, mbi 90% e prurjeve në disa prej lumenjve mund të vijnë nga ujqerat nëntokësore.


13.2 Problematikat Aktuale

Në Figurën 13.1 paraqitet hartëzimi i dherave të nëntokës dhe një përshkrim i përgjithshëm dhe kapaciteti i pritshëm prodhues i ujqerave nëntokësore. Formacionet me prodhim të lartë lidhen ngushtësisht me formacionet gëlqerore dhe karstike, si dhe me depozitimet sedimentare aluviale në ultësirën bregdetare. Nuk ka përshkrim mbi shpërndarjen e

rezervuarëve në basen. Megjithatë, dihet se ekzistojnë të paktën dy rezervuarë me ujëra nëntokësorë, përkatësisht akuiferët në Fushë Kuqe dhe Lezhë, që ndodhen në zonën bregdetare dhe në korridorin ku Lumi i Matit rrjedh drejt Detit Adriatik. Të dy akuiferët përbëhen nga shtresa kuaternare me një trashësi prej 150 deri në 280 m. Sedimentet prej zhavorri formojnë shtresa që ndahen nga shtresa sedimentesh prej argjile.

Baseni sedimentar në pjesën qendrore të Basenit të Matit si dhe zonat me shkëmbinj intruzivë karakterizohen nga një nivel ujëmbajtës i ulët deri në të mesëm të lartë.

Figura 13.1 Karakterizimi sasior i kapacitetit të prodhimit të ujërave nëntokësore lidhur me përbërjen e shtresës së nëntokës.



Burimi: Plani ekzistues i Menaxhimit të Basenit Ujor të Matit

BASENI UJOR I MATIT

Pikat e shpimit
Burimet > 10 l/sec
Akuiferët dhe prodhimi i ujërave nëntokësore

Formacionet jouëmbajtëse
Argjilë dhe gurë ranorë, më pak gurë gëlqerorë
Gurë, rreshpe - më pak gurë ranorë, argjilë dhe gurë gëlqerorë


Formacione me ujëmbajtje të ulët dhe të mesme
Shkëmbinj intruzivë, ultrabazikë-gjarpërues
Gurë ranorë, konglomerate, argjilë dhe aleurolite

Formacione me ujëmbajtje të lartë
Zhavorr dhe depozita aluviale
Gurë gëlqerorë dhe shumë të karstifikuar
Masive gëlqerore shumë të karstifikuara

Në DKU, ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore konsiderohen si r burime të menjpërdimta. Duke qenë se akuiferët në Fushë Kuqe dhe Lezhë shtrihen përtej korridorit dhe kufijve ekzistues të Basenit të Matit, duhet të merret në

konideratë rishikimi i kufijve të basenit dhe të përfshihet në to një pjesë e konsiderueshme e ultësirës bregdetare në rrjedhën e poshtme në Milot. Në Figurën 13.2 paraqitet hartëzimi në kontekst rajonal i formacioneve gjeologjike në basen. Nga figura mund të vërehet se formacionet gjeologjike kryesore pasqyrohen në të njëjtën mënyrë si ato për nëntokën dhe kapacitetin e saj ujëmbajtës.

Figura 13.2 Gjeologjia në Basenin Ujor të Matit



Burimi: Plani ekzistues i Menaxhimit i Basenit Ujor të Matit

Një nga problematikat kryesore lidhur me gjeologjinë në Basenin e Matit ka të bëjë me masivin e Bulqizës²⁴, që në hartën gjeologjike përshkruhet si piroksenet dhe dunitet e periudhës Xhurasike të mesme që rrethojnë kufijtë e Basenit të Matit. Piroksenet dhe dunitet janë gjatë mineralizimit dhe përmbajnë një përqindje të lartë kromitësh, që ka qenë dhe mbetet një nga synimet e veprimtarive minerare. Kjo përmbajtje mund të pasqyrohet dhe në karakteristikat kimike të ujërave nëntokësore dhe atyre sipërfaqësore.

Në pjesën jugore të basenit, piroksenet dhe dunitet nga masivi i Bulqizës kufizohen nga karbonatet dhe dolomitet nga Trias-Jura i epërm duke krijuar një zonë karstike plot me ujë burimi dhe ujëra nëntokësore. Në pjesën veriore ka më pak karbonate në formacionet gjeologjike. Kjo zonë dominohet nga bazalte ultrabazike andezitike eruptive, që janë kompakte dhe me më pak çarje dhe kapacitet transmetues, siç paraqitet në Figurën 13.2.

Kapacitetet e larta prodhuese lidhen ngushtësisht me depozitimet aluviale Holocene, që janë me origjinë detare dhe nga ujëra të ëmbla në zonën kalimtare të Grykës së Matit, dhe që ka gjasë të jenë nën ndikimin e klorurit dhe elektroliteve detare.

Marrjet nga ujërat nëntokësore duhet të rregullohen nëpërmjet sistemit të Lejes për marrje Uji, ku autoriteti kompetent është AMBU-ja. Monitorimi i statusit sasior të ujërave nëntokësore dhe kushteve fizike dhe kimike është përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) është autoriteti kompetent për ofrimin e ekspertizës teknike të rëndësishme për identifikimin e cilësive dhe statusit gjeologjik të akuiferëve që përdoren për furnizimin me ujë.

Ekzistojnë 6 stacione të monitorimit të ujërave nëntokësore. Ato ndodhen në Shpimi Toma (pranë Nderfanit), Gurrëz (në akuiferin e Fushë Kuqes), në Hotelin e Gjuetisë (në akuiferin e Lezhës), Barbullojë (në akuiferin e Lezhës), Ishull Lezhë (në akuiferin e Lezhës) dhe Rilë (në akuiferin e Lezhës).

Këto stacione monitorimi kryejnë monitorimin e statusit sasior dhe kimik të ujërave nëntokësore në akuiferët e Fushë Kuqes dhe Lezhës dy herë në vit. Analizat përqendrohen te elektrolitet, kloruri, alkaliniteti, nitratet dhe nitritet dhe sulfati. Ndonjëherë monitorohen dhe metalet si kromi, bakri dhe mangani. Mikrondotësit organikë si pesticidet dhe hidrokarburet poliaromatike nuk analizohen ende.

Në disa pika, vlerat e pH, fortësisë, mineralizimit, Na, Ca, Mg, Fe, Cl dhe/ose SO₄ tejkalojnë standardet në fuqi të cilësisë së ujërave nëntokësore në Shqipëri. Megjithatë, kjo nuk nënkupton medoemos trysni antropogjenike. Përqendrimet e larta të këtyre parametrave mund t'u atribuohen kushteve specifike gjeogjenike natyrore vendase ose depërtimit të ujit të detit.

²⁴ Shembull: H. Beshku, A. Dobi, V. Gjoni dhe A. Pirdeni Gjeologjia, Petrologjia dhe mineralizimi kromit i Masivit ultramafik të Bulqizës. Punimet e Kongresit të XVII të Shoqatës Gjeologjike Karpatiane – Ballkanike. Bratislavë, 1-4 shtator 2002

13.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Shumica e ujërave nëntokësore duket se janë ende me cilësi të mirë, megjithëse të dhënat e monitorimit janë të pamjaftueshme për të vlerësuar ndotjen e mundshme të tyre nga pesticidet ose metalet e rënda, ndër të tjera.

Megjithatë, duket se sasia ekzistuese e burimeve të ujërave nëntokësore është nën trysni të madhe, dhe shfrytëzimi i tyre kërkon urgjentisht më shumë evidenca teknike dhe një regjim menaxhimi më proaktiv. Burimi vjetor i rinovueshëm i ujërave nëntokësore kërkon një përlllogaritje të plotë dhe të saktë të bilancit të ujit, gjë e cila kërkon një rrjet të përmirësuar pikash shpimi për vëzhgim.

AMBU-ja duhet të kontrollojë përdorimin e gjerë të ujërave nëntokësore për vaditje pa Lejet e posaçme. Të gjitha nxjerrjet e këtij lloji duhet të rregullohen rreptësisht. DKU dhe DUN përcaktojnë se të gjithë trupat ujorë nëntokësorë të përdorur si burime uji të pijshëm ose që janë me rëndësi ekologjike duhet të identifikohen individualisht dhe t'i nënshtrohen menaxhimit të përshtatshëm sasior dhe cilësor. Kjo nuk është kryer ende. Më e rëndësishmja, as zonat e mbrojtjes për pikat e marrjes së ujërave nëntokësore nuk janë përcaktuar dhe as hartëzuar.

13.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 13-1 – Veprime të mundshme për Programin e Masave

Shfrytëzimi, Mbrojtja dhe Monitorimi i Ujërave Nëntokësore	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Koeficientët shumë të lartë të përdorimit sugjerojnë se marrja e ujërave nëntokësore së shpejti mund të bëhet e paqëndrueshme.	Duhet të përcaktohet një bilanc vjetor i ujit në bashkëpunim me SHGJSH-në, në mënyrë që të sigurohet se niveli i marrjeve të përgjithshme është më i ulët se burimi vjetor i rinovueshëm.
Shumë nga marrjet e ujërave nëntokësore janë të jashtëligjshme ose kryhen pa Leje. Shumë nga vendet e nxjerrjes nuk dihen.	AMBU-ja duhet të kryejë studime dhe të krijojë një regjistër të plotë ku do të regjistrohen të gjitha marrjet, i cili do të përfshihet në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.
Trupat ujorë janë ende të paidentifikuar, ose karakteristikat dhe trysnitë e tyre nuk njihen sipas Aneksit II të DKU-së.	Duhet të kryhet karakterizimi fillestar dhe i mëtejshëm i trupave ujorë individualë në përputhje me procedurat e përcaktuara kombëtare. Kjo gjë kërkon bashkëpunim ndërmjet AMBU-së dhe SHGJSH-së.
Burimet e ujërave nëntokësore që përdoren për furnizim me ujë të pijshëm nuk mbrohen në nivelin e duhur. Shumë prej këtyre burimeve ndodhen pranë zonave urbane, ndaj dhe risku për ndotjen e tyre është i konsiderueshëm.	Burimet kyçe të ujit të pijshëm duhet të hartëzohen dhe të përcaktohen me zona mbrojtëse. Këto harta duhet t'u vendosen në dispozicion autoriteteve bashkiake për qëllime të kontrollit të zhvillimit.
Tendencat e ndotjeve të ujërave nëntokësore dhe nivelet e substancave prioritare nuk janë të kuptuara mirë ose nuk janë të publikuara. Rrjeti i monitorimit ka gjasë të jetë i papërshtatshëm për përcaktimin e statusit të të gjithë trupave ujorë kryesorë.	AKM-ja dhe AMBU-ja duhet të bashkëpunojnë për publikimin periodik të vlerave dhe tendencave të ndotësve të ujërave nëntokësore. Rrjeti i monitorimit duhet të rivlerësohet dhe të financohet në nivelin e duhur për të siguruar paraqitjen e një statusi përfaqësues të të gjithë trupave ujorë.

14. Cilësia e Ujërave Bregdetare, Ujërat për Larje, Habitatet

14.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme

Ujërat bregdetare janë me rëndësi të veçantë në Planin e Menaxhimit të Basenit Ujor. Zonat bregdetare janë nën trysni nga ndotja e mundshme prej shkarkimit të lumenjve; shumë zona bregdetare ofrojnë habitate dhe ligatina të konsiderueshme për speciet me rëndësi; plazhet bregdetare janë një burim i konsiderueshëm me vlerë ekonomike për shkak të turizmit.

Direktiva e BE-së mbi Ujërat për Larje (DUL) 2006/7/EC mbron shëndetin publik dhe ujërat e pastra të larjes. Ajo iu kërkon Shteteve Anëtare të monitorojnë dhe vlerësojnë ujërat e larjes lidhur me dy parametra bakteriale (fekale). Krahas kësaj, ato duhet të informojnë publikun mbi cilësinë e ujërave të larjes dhe menaxhimin e plazhit, nëpërmjet të ashtuquajturave profile të ujërave të larjes. Këto profile përmbajnë informacion mbi llojin e ndotjes dhe burimet që ndikojnë në cilësinë e ujërave të larjes dhe që përbëjnë risk për shëndetin e larësve (siç janë shkarkimet e ujërave të ndotura).

Politika Bregdetare dhe Detare e BE-së nëpërmjet Direktivës 2008/56/EC ofron shtysën ligjore për BE-në për mbrojtjen dhe pastrimin e brigjeve detare, deteve dhe oqeanëve të saj si pjesë e një strategjie të integruar që do të mundësojë përdorimin e qëndrueshëm të tyre.²⁵

14.2 Problematikat Aktuale

Sistemi i lumenjve në Basenin e Matit arrin në Bregdetin e Adriatikut nëpërmjet një korridorit ujërash kalimtare dhe ultësirave bregdetare të kanalizuar në Fushë Kuqe.

Ujërat kalimtare dhe bregdetare përbëjnë një pjesë të vogël të basenit dhe, për shkak të kompleksitetit hidrologjik dhe mungesës së monitorimit sistematik në zonë, duhet të adresohen si pjesë e një studimi më të gjerë të zonave të ultësirave bregdetare në Shqipëri.

Zonat bregdetare të Lezhës dhe Kurbinit karakterizohen nga një rrjet i ngjeshur skemash vaditjeje dhe kanaleve të kullimit të cilat gjithashtu karakterizohen si trupa ujorë artificiale dhe të modifikuar. Edhe në ultësirat bregdetare të rrjedhës së poshtme në Milot ekziston një rrjet i ngjeshur i kanaleve të kullimit që mund të karakterizohen si trupa ujorë artificiale, të modifikuar dhe kalimtarë.

Përgjatë bregut janë disa laguna bregdetare: Merxhan (300 ha), Kune (800 ha), Vain (1500 ha), dhe Patok (2200 ha).

Lagunat kanë karakteristika gjeomorfologjike të ngjashme me sedimente të buta fundore mbi argjilë kompakte dhe material organik. Thellësia e tyre është rreth 0.3-1.5 m, kripësia 15-40‰/00, temperaturat janë ndërmjet 5-32°C dhe vlerat e oksigjenit janë 2.8 mg/l.

Këto laguna janë të rëndësishme për shkak të nivelit të lartë të biodiversitetit në to, si dhe për interesa ekonomike që lidhen me turizmin, peshkimin, gjuetinë etj. Në veçanti, Laguna e Patokut, e shtrirë ndërmjet dy grykave të lumenjve Droj dhe Mat, shërben si një zonë e rëndësishme ushqyerjeje për breshkat e detit të cilat janë të rrezikuara në nivel botëror.

²⁵https://ec.europa.eu/environment/marine/index_en.htm

Ujërat e lagunës janë të pasura me peshq, kryesisht me qefull dhe ngjalë, dhe në brendësi të lagunave bregdetare praktikohet tradicionalisht akuakultura.

Të gjitha sistemet e lagunës mund të pësojnë stres për shkak të ndryshimeve klimatike, dhe mund të kërcënohen në një farë mase në planin afatgjatë nga sedimentimi, ndotja minerale e kanaleve dhe ndonjëherë nga anoksia hipertrofike, si dhe nga ndotja shtëpiake dhe industriale.

14.3 Pasojat dhe Nevojat në të Ardhmen

Në Shqipëri nuk kryhet monitorimi i ujërave tranzitore dhe atyre bregdetare.

Propozohet që të zgjerohet programi kombëtar i monitorimit nga AKM-ja për ujërat tranzitore, lagunat dhe ujërat bregdetare pasi aktualisht nuk disponohen të dhëna të qarta.

14.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 14-1 – Veprime të mundshme për Programin e Masave

Cilësia e Ujërave Bregdetare, Ujërat për Larje, Habitatet	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
Në Shqipëri nuk kryhet monitorimi i ambientit të ujërave kalimtare dhe atyre bregdetare.	Propozohet që të zgjerohet programi kombëtar i monitorimit nga AKM-ja për ujërat tranzitore, lagunat dhe ujërat bregdetare pasi aktualisht nuk disponohen të dhëna të qarta. Përgatitja e skemave dhe protokolleve në përputhje me DKU-në për vlerësimin e statusit të ujërave bregdetare.
Informacion i pakët mbi llojet e habitateve dhe statusin e tyre	Kryerja e studimeve në përputhje me DKU-në për identifikimin dhe vlerësimin e habitateve bregdetare.
Informacion i kufizuar ose i munguar mbi veprimtarinë bregdetare dhe ndikimin e saj	Kryerja e studimeve për identifikimin e veprimtarive bregdetare dhe ndikimit të tyre në cilësinë e ujërave bregdetare

15. Menaxhimi i Vijës Bregdetare, Risku i Përmbytjeve dhe Erozioni

15.1 Përse kjo problematikë është e rëndësishme

Rajonet bregdetare të paprekura në Shqipëri janë një nga asetet natyrore më të rëndësishme në vend. Vendi ka një sërë ligatinash me rëndësi shkencore dhe ekologjike, dhe plazhet dhe resortet bregdetare janë një burim i konsiderueshëm të ardhurash nga turistët.

Dendësia e lartë e ndërtimeve në vijën bregdetare dhe nivelet përkatëse të turizmit të ardhshëm janë veçanërisht të cenueshme nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Ngritja e nivelit të detit është një nga kërcënimet më kritike të ndryshimeve klimatike. Për shembull, ngritja e nivelit të detit në 48-61 cm për vitin 2100 do të rezultojë në përmbytje të konsiderueshme në shumë nga zonat bregdetare, duke cenuar në nivel të lartë ekonominë bregdetare dhe ka gjasë të shkaktojë zhvendosjen e komuniteteve të tëra.²⁶

Trupat ujorë bregdetarë dhe kalimtarë duhet të përcaktohen dhe karakterizohen në mënyrë specifike në PMBU, megjithëse ka gjasë që rajonet bregdetare do të menaxhohen sipas një programi të veçantë të përcaktuar për menaxhimin bregdetar ose sipas një strategjie të ngjashme që do të zbatohet nga autoriteti kompetent, në rastin konkret Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB).

15.2 Problematikat Aktuale

Së fundmi, Shqipëria ka finalizuar Planin Ndërsektorial të Menaxhimit të Bregdetit me një afat nga viti 2017 deri në 2030. Kërcënimet kryesore për zonat bregdetare të Shqipërisë përfshijnë erozionin, peshkimin e tepërt, ndotjen dhe ndikimet e mundshme nga ndryshimet klimatike.²⁷ Duhet të zhvillohen strategji gjithëpërfshirëse për përballimin e ndikimeve të pritshme të ndryshimit klimatik si pjesë e Planit Ndërsektorial të Menaxhimit të Bregdetit.

Në veçanti, ngritja e nivelit të detit mund të shkaktojë ndikim të drejtpërdrejtë, që përfshin përmbytje dhe zhvendosje të ligatinave dhe ultësirave, erozion përgjatë bregdetit, shtim të përmbytjeve dhe dëmeve nga stuhitë, rritje të kripësisë në gryka dhe akuiferët bregdetarë, dhe rritje të pasqyrave ujore bregdetare

Veprimtaritë argëtuese dhe turizmi kërkojnë “cilësi të lartë të ujërave të larjes”. Gjithashtu, turistët kanë kërkesa lidhur me ujin e pijshëm, jo vetëm për konsum por dhe për larje dhe pastrimin e tualeteve, për shembull. Kjo do të shkaktojë prodhimin e ujërave të ndotur si rezultat.

Erozioni në bregdet është një problem i konsiderueshëm në rajonet bregdetare veriore dhe ato qendrore. Shkarkimet e sedimenteve nga lumenjtë janë në nivel relativisht të lartë, çka shpjegon natyrën dinamike të zhvillimit deltaik të bregdetit.

²⁶ Climate Central - E ARDHMJA E PËRMBYTUR: Cenueshmëria Botërore nga Ngritja e Nivelit të Detit më Serioze nga sa Mendohej më Parë [Global Vulnerability to Sea Level Rise Worse Than Previously Understood] 2019

²⁷ UNECE - Shqipëri- Vlerësimet e Performancës Mjedisore, Vlerësimi i Tretë, 2018

15.3 Pasoja dhe Nevojat në të Ardhmen

Objektivat mjedisore të Planit Ndërsektorial të Menaxhimit të Bregdetit duhet të përputhen me objektivat mjedisore të përcaktuara për trupat ujorë kalimtarë dhe bregdetarë, siç parashikohet në Planin gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Basenit Ujor. Kontrolli i erozionit është praktika e ristabilizimit të pritave të lumenjve dhe përrenjve pas përmytjeve, me qëllim sigurimin e zhvillimeve në zonën përreth. Masat e kontrollit të erozionit mund të përdorin veprat inxhinierike të rënda, siç janë muret mbajtëse për parandalimin e erozioneve në të ardhmen. Megjithatë, kjo gjë pengon meandret natyrore të lumenjve. Opsionet më natyrore përfshijnë pritrat me gurë, pritrat me guralecë dhe bimësinë për të përthithur ujin e tepërt dhe për të parandaluar shkatërrimin e brigjeve. Kontrolli i erozionit është me rëndësi për mbrojtjen e strukturave të krijuara nga dora e njeriut.

15.4 Masat që mund të zbatohen në Kuadër të Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor

Tabela 15-1 – Veprime të mundshme për Programin e Masave

Menaxhimi i Vijës Bregdetare, Përmytjet dhe Erozioni	
Problematika të Mundshme	Komentet në nivel drejtimi për trajtimin e problematikës
<p>Erozioni i zonave bregdetare dhe përmytjet janë rreziqe që, në kombinim me faktorët lehtësues dhe receptorët e cenueshëm, përbëjnë burime të risqeve bregdetare.</p> <p>Risku për erozion dhe përmytje shpeshherë analizohet veçmas për shkak të lidhjes së ndërlikuar ndërmjet proceseve nxitëse, reagimit morfologjik dhe receptorëve të riskut.</p> <p>Morfologjia bregdetare modifikon rrezikun nga përmytjet; risku nga përmytjet në të ardhmen varet nga pozicioni i ndryshueshëm i vijës bregdetare.</p>	<p>Identifikimi dhe zbatimi i projekteve të kontrollit të erozionit që përfshijnë sigurimin e brigjeve të kanaleve, kontrollin bimor të erozionit, dhe strukturat mbajtëse inxhinierike.</p> <p>Shqyrtim i Planit ekzistues Ndërsektorial të Menaxhimit të Bregdetit duke marrë në konsideratë objektivat mjedisore të përcaktuara për trupat ujorë kalimtarë dhe bregdetarë, siç parashikohet në Planin gjithëpërfshirës të Menaxhimit të Basenit Ujor.</p>

16. Programi i Zbatimit

Angazhimi dhe përfshirja e palëve të interesit në menaxhimin e ujërave është një nga temat kryesore të DKU-së. Sigurimi dhe mundësi i kësaj pjesëmarrjeje dhe këtij ndikimi përbën pjesë thelbësore të procesit të planifikimit të basenit ujqor.

Qëllimi kryesor i konsultimit është sigurimi i transparencës dhe lehtësimi i angazhimit të palëve të interesit në procesin e planifikimit të baseneve ujqore.

Angazhimi nënkupton përfshirjen e palëve të interesit në një proces të qartë planifikimi me mundësi që palët e interesuara të aksesojnë, kontribuojnë dhe shkëmbejnë informacione, dhe të kontribuojnë në analizimin dhe proceset që çojnë drejt zgjedhjeve mbi dakortësime dhe vendim marrje. Ky angazhim tërësor nuk ka gjasa të realizohet vetëm në nivelin e baseneve ujqore; Angazhimi në nivelin vendor dhe atë të pellgut ujëmbledhës duhet të mbështesë dhe nxisë zhvillimin e PMBU-ve të përditësuara dhe programeve të masave. AMBU-ja do të ndërmarrë hapa për lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet palëve të interesit në shkallë të ndryshme gjeografike, në mënyrë që menaxhimi i pellgut ujëmbledhës të të koordinohet me planifikimin efektiv të basenit ujqor.

Në tabelën më poshtë paraqitet një përmbledhje e përgjithshme e Fazave të Konsultimit për Planin e Menaxhimit të Basenit Ujqor të Matit 2022-2027.

Gjatë periudhës 6-mujore të konsultimit do të organizohen tre seminare për të diskutuar dhe marrë sugjerime të përshtatshme lidhur me Problematikat Kryesore të Menaxhimit të Ujit. Në secilin seminar do të ftohen të marrin pjesë palët e interesit nga niveli kombëtar dhe ai i basenit.

Është me rëndësi që AMBU-ja të angazhohet me palët e interesit lidhur me çdo problematikë të ngritur, dhe për mënyrat e menaxhimit të tyre në PMBU.

